



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.01.2019, ora 09:00

Drejtton mbledhjen:

Albana Vokshi - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”(komision përgjegjës).
2. Seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Besa Shahini, në kuadër të shqyrtimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” (komision përgjegjës).
3. Vendim i komisionit për shpalljen e 3 vendeve vakante për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Endri Hasa(zëvendësues) dhe Floida Kërpaçi(zëvendësues).

Mungojnë:

Romeo Gurakuqi.

Të ftuar:

Besa Shahini – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Oltjon Muzaka – sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Redi Shtino – këshilltar i ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,
Fatjon Hoxhalli – këshilltar i ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Për shkak të angazhimeve të tjera të ministres, na duhet të ndryshojmë edhe mënyrën se si do të procedojmë. Fillimisht dua t'ju jap fjalën dy propozueseve, Kejdi Mehmetaj dhe Floida Kërpaçi, që shkurtimisht të na paraqesin amendamentet që kanë bërë për ligjin e arsimit të lartë. Ju lutem, sa më të përmbledhur fjalën tuaj, sepse duam kohën e nevojshme për të pyetur dhe për të ngritur shqetësimet e ndryshme me ministren e Arsimit.

Fjala për ju.

Kejdi Mehmetaj- Faleminderit! Të nderuar kolegë.

Propozimet që ju keni përpara, për të cilat thoni se nuk kanë nevojë për një prezantim të zgjeruar, sepse deputetët kanë pasur të gjithë kohën e nevojshme për t'i parë, janë propozime që realisht dhe sinqerisht ju themi se ne nuk kemi pasur ndonjë kontribut të jashtëzakonshëm, përveçse kemi bërë detyrën tonë si deputete të zgjedhura në këtë legjislaturë për të përfaqësuar në radhë të parë të rinjtë shqiptarë, sidomos studentët, pasi si vetë student, ne jemi bërë pjesë e këtij parlamenti.

Duke parë reagimin krejtësisht arrogant dhe të pavend të qeverisë, e cila në asnjë moment nuk synoi që t'i trajtonte drejt kërkesat e studentëve, përkundrazi, i denigroi dhe i ofendoi ata, madje duke i nxitur, ashtu siç e shohim edhe sot, drejt veprimeve që cenojnë në një lloj forme edhe shëndetin e tyre. Siç e thashë edhe para dy ditësh në Komisionin e Ekonomisë dhe siç e thashë edhe dje në komisionin tone, studentët vazhdojnë të jenë të ngujuar dhe flenë nëpër auditorët e shkollave, si formë proteste që ata kanë zgjedhur për realizimin e 8 kërkesave të tyre dhe sot ata janë të sëmurë, një pjesë e tyre gjenden nëpër spitale dhe askush nuk po e vret mendjen për këtë fakt. Ne në ditën e tetë të protestës së tyre, në datën 12 dhjetor, duke e parë të arsyeshme që nuk ishte me vend që mijëra studentë të vazhdonin të ishin në shesh duke protestuar dhe të vazhdonin të ishin larg auditorëve të tyre, në një komunikim me studentët, morëm 8 kërkesat e tyre, pa u ndryshuar asnjë presje, i kthyem në një gjuhë ligjore si amendime dhe i sollëm në parlament. Studentëve do t'ju duhej disa kohë që t'i sillnin në parlament, kjo për shkak të mbledhjes së 20 mijë firmave. Ne, si deputete, që i përfaqësojmë ata dhe jemi zëri i tyre në parlament, mund t'i sillnim këto ndryshime këtu. Pra, e përsëris edhe një herë, në këto amendamente nuk do të gjeni thjesht dhe vetëm një mendim tonin lidhur me përfaqësimin e studentëve në të gjithë organet drejtuese të universiteteve, por kërkesën e vetë

studentëve që ata të jenë të përfaqësuar denjësisht dhe aq sa ata e gjykojnë që përfaqësimi i tyre merr një vlerë reale.

Në fakt, propozimet e tyre erdhën vetëm në ditën e tetë të protestës, atëherë kur ne dhe të gjithë ju morëm përpara listën e 8 kërkesave dhe i dëgjonim ata që flisnin nga protesta, por sot, në ditën e 56-të ose të 57-të të protestës së tyre, duket se kërkesat e tyre kanë marrë trajta të tjera dhe duket sikur ata janë thelluar. Ndoshta shërbeu edhe arroganca e qeverisë për t'i bërë ata të mendojnë më thellësisht jo vetëm për të tashmen, por edhe për të ardhmen e tyre dhe ajo që marrin në universitet do t'u shërbejë nesër për të qenë profesionistë të zotë, të përgatiten sot për të përballuar tregun e punës nesër, ligjet që ky parlament ka miratuar t'u shërbejnë atyre në të vërtetë dhe jo interesave klienteliste të atyre që i kanë propozuar, që i kanë votuar, madje që i plotësojnë herë pas here edhe me akte nënligjore, të cilat janë në kundërshtim jo vetëm me vetë ligjet e miratuara, por edhe me autonominë e universiteteve, e cila nuk është vetëm një e drejtë që jep ligji, por mbi të gjitha Kushtetuta. Pra, e thënë në këtë kuptim, ditët në vazhdim, pas datës 12 që ne bëmë propozimin, hodhën në tryezë diskutimesh shumë amendime të tjera, të cilat duhet t'i bëhen ligjit për arsimin e lartë, hodhën në diskutim të gjitha aktet nënligjore që janë ndërmarrë që nga miratimi i këtij ligji, sa brenda kufijve dhe frymës së ligjit janë ato dhe sa brenda autonomisë që ligji duhet t'u japë universiteteve janë ato.

Nga ana tjetër, u pa qartë se interesat e qeverisë ishin vetëm të gjenin pamjet më të bukura mashtruese që t'i bënin studentët të dilnin nga rruga, duke vazhduar me sloganet, që besoj se janë ekspertë për t'i gjetur, të cilat i kemi parë në komisionin tonë prej vitesh, ku njëri nga sloganet ishte "Pakti për universitetin", por që ngelet, si gjithmonë, në ëndrrat dhe fantazitë e Kryeministrit, të cilat gjatë ditës thuhën nëpërmjet ministrave të tij, por që askush nuk di të na thotë se si do të realizohen dhe nëse vërtet do të kenë një impakt te studentët.

Nga ana tjetër, duket se protesta e studentëve shërbeu për të gjitha institucionet për të reflektuar, ku njëri nga ata ishte Kontrolli i Lartë i Shtetit, që gamës së raporteve të tij lidhur me arsimin e lartë në veçanti t'i shtonte edhe disa raporte të reja, që po ashtu tregojnë shkelje flagrante të ligjit me aktet nënligjore, por, nga ana tjetër, edhe abuzime me fondet. Situata sot është që pas 56 ditësh ende kemi zyrtarë dhe përfaqësues të qeverisë që dalin dhe nuk i trajtojnë siç duhet kërkesat e studentëve, të cilëve u janë bashkuar edhe pedagogët, por merren me etiketime të studentëve dhe me denigrim të figurës së tyre. Rasti i fundit ishte dje, ku një prej ministrave, ajo që mbulon lidhjet me parlamentin, vazhdoi me gamën e madhe të fyerjeve ndaj studentëve, edhe pse askush prej tyre nuk e ka marrë realisht mundimin që të shkojë t'i takojë dhe dëgjojë ata, por shkojnë me idenë për t'i nxjerrë nga salla, pasi nuk janë mjaftueshëm në lartësinë e komunikimit imagjinar dhe 3D të Kryeministrit. Askush nuk ka shkuar për të parë

si është gjendja e tyre shëndetësore, madje dalin edhe me vendime që janë po aq qesharake dhe antiligjore, saqë shpikin salla të reja leksionesh dhe mësimdhëniesh, ku qartazi ligji përcakton mënyrën se si vendosen hapësirat se ku do të zhvillohet mësimi.

Ajo që më habit më shumë se çdo gjë tjetër, këtë e pamë edhe te përgjigja që na erdhi nga Ministria e Arsimit lidhur me amendimet që ne kemi propozuar, është se sa të hapur janë ata për të bërë ndryshime reale në zbatimin e ligjit dhe studentët të kthehen në auditorë dhe jeta universitare të vazhdojë siç duhet dhe siç u takon të rinjve shqiptarë.

Edhe në raportin që erdhi nga ministria, dukej qartazi kokëfortësia që qeveria ka në raport me të vërtetën, por edhe kokëfortësia që qeveria ka në raport me zbatimin e kërkesave të studentëve dhe të profesorëve, të cilat janë pranuar në të gjithë Shqipërinë si krejtësisht legjitime.

Unë mund të flas këtu edhe për anën njerëzore të detyrës sonë, qoftë ne, si të reja në moshë karshi jush, por edhe ju si prindër dhe si profesorë, sepse një pjesë juaja ka shërbyer për shumë vjet në sallat e auditorëve dhe shpresoj që në ndërgjegjen e secilit prej jush të ketë një brengë sado të vogël, që prej 50 e disa ditësh universitetet tona nuk funksionojnë, asnjë prej tyre, edhe pse ka një tendencë nga ana e qeverisë për të shitur lajme të rreme se gjasme një pjesë janë futur në mësim dhe pjesa tjetër vazhdon e proteston. Të gjithë studentët protestojnë, secili me mënyrën e tyre dhe me formën që ata kanë zgjedhur. Dua t'ju lutem që në ndërgjegjen tuaj të mendoni për të ardhmen e këtyre studentëve, të mendoni dëmin që u shkaktohet atyre dhe universiteteve tona për shkak të kësaj mungese të madhe dhe në mënyrë të menjëhershme të distancoheni nga qëndrimet refraktare të qeverisë, ndaj qëndrimeve të qeverisë kundër studentëve dhe të marrim në dorë, ashtu siç na takon, me të drejtat që na jep Kushtetuta si të zgjedhur, fatin dhe zgjidhjen e kësaj situatë, duke filluar me ndërhyrjet imediate dhe duke hapur një diskutim shumë më të gjerë për arsimin e lartë dhe arsimin në përgjithësi.

Ashtu siç e thashë edhe ditën e parë kur diskutuam për kalendarin, ne e kuptojmë se që nga dita kur kemi propozuar këto amendime dhe deri sot situata ka precipituar shumë, ndaj edhe ne kërkuam që këto amendime të shërbejnë si një fillesë e mirë e një diskutimi të gjerë për ligjin e arsimit të lartë, për aktet nënligjore, për buxhetin që duhet të suportojë të gjitha ndryshimet, por edhe për punën që është bërë deri tani në universitete.

Unë mendoj se ky moment duhet të na shërbejë për të reflektuar dhe një herë e mirë të arrijmë të bëjmë diferencën se cili prej nesh është me të vërtetë me studentët dhe qytetarët shqiptarë dhe cili prej nesh është i lidhur aq fort me karrigen dhe pushtetin, saqë për hir të karriges dhe të pushtetit është i gatshëm të shesë edhe shpirtin, sepse, duke shitur studentët, siç kemi bërë këto ditë, kemi shitur në radhë të parë shpirtin tonë.

Faleminderit!

Floida Kërpaçi – Të nderuar kolegë,

Ashtu siç e prezantoi edhe kolegja Mehmetaj, këto amendamente kanë lindur që në ditën e 8 të protestës së studentëve. Pse nisi kjo protestë? Pse studentët u çuan të revoltuar kundër një sistemi, që mund ta themi me plot bindje se është sistemi i antivlerave që Edi Rama ka ngritur përballë një shoqërie me plot vlera, me plot mundësi për të ndërtuar një Shqipëri më të mirë?! Studentët u ngritën, sepse tarifat ishin shumë të larta dhe të gjendur në një rrënojë dhe në një mjerim ekonomik të familjeve të tyre, ishte e pamundur t'i përballonin ato. Studentët u ngritën për kushtet e mjerueshme në konvikte, u ngritën për problemet e tjera në arsimin e lartë, u ngritën për të rritur përfaqësimin e tyre dhe për t'i thënë stop kësaj qeverie, që jo vetëm nuk i përfaqëson ata, por edhe i përbuz e i shpërfill me politika denigruese. Prandaj Gallupi nxori studimin, ku thotë se 79% e të rinjve duan të largohen, sepse janë të pashpresë dhe nuk e shohin të ardhmen në vendin tonë. Kjo është mbi çdo mashtrim, mbi çdo shou, mbi çdo video 3D që Edi Rama dhe qeveria e tij me shumë krenari nxjerrin përballë një shoqërie, e cila sot jeton në mjerim dhe nuk e shikon të ardhmen në Shqipëri, por e shikon jashtë saj dhe, pa diskutim, në detyrën tonë si ligjvënës dhe si përfaqësues e të rinjve në ditën e 8-të morëm iniciativën për të përkthyer kërkesat e tyre në ndryshime ligjore. VKM-të nuk janë garanci, sepse Kryeministri mund të dalë nesër, lajthit dhe këto VKM hiqen. Pastaj çfarë do të ndodhë me kërkesat e studentëve? Prandaj është jashtëzakonisht shumë e rëndësishme kthimi i kërkesave të studentëve në ndryshime ligjore. Pse them që këto mund të ndryshojnë?! Sepse Kryeministri ka treguar që nuk i mban premtimet e tij. Ai u ka premtuar shqiptarëve 300 mijë vende pune dhe nuk e ka mbajtur premtimin, ai ka premtuar që do të ketë shëndetësi falas dhe nuk e ka mbajtur, doli dhe premtoi nëpërmjet paktit 3D të universitetit, sepse, në fakt, 3D nuk është real, dhe studentët nuk i jetojnë ato ndryshime. Cila është përgjigjja e tyre? Përgjigjja e tyre, sado që ju thonë se pakti është i zgjidhur, është që ata vazhdojnë ende sot të jenë të ngujuar. Pavarësisht vështirësive dhe sfidave ata janë aty dhe janë të bindur që do të vazhdojnë deri në plotësimin e kërkesave të tyre. Prandaj, amendamentet që keni përpara janë zgjidhja e asaj që ata kërkojnë. Ata kërkojnë rritjen e përfaqësimit të tyre, në mënyrë që të kenë një zë më të fortë për problemet që ata kanë dhe t'u japin zgjidhje këtyre problemeve.

Unë mendoj se jemi shumë të hapur të vazhdojmë diskutimet, por një gjë është e sigurt, e thashë edhe në Komisionin e Ekonomisë kur diskutuam për amendamentin për ndryshimin për buxhetin e vitit 2019, që kjo e sotmja është një vijë ndarëse ndërmjet atyre që i mbështesin realisht studentët dhe atyre që mbështesin fasadat, shoun dhe që nuk e duan mbështetjen reale ndaj studentëve.

Ne të gjithë jemi për një arsim cilësor. Detyra dhe përgjegjësia jonë është që ne t'i përfaqësojmë kërkesat e të rinjve dhe studentëve. Është momenti që ne të bashkohemi për një arsim cilësor dhe të lëmë mënjanë paktet, shout, përçarjet, sharjet dhe denigrimin e pedagogëve, studentëve dhe të çdo aktori tjetër, vetëm se guxojnë të dalin kundër qeverisë, dhe të bëhemi bashkë për vendin tonë dhe për të ardhmen e të rinjve, sepse kërkesat e tyre i keni të gjithë përpara për t'i diskutuar, për të parë të ardhmen e tyre dhe vazhdimësinë e zgjidhjes së kërkesave të studentëve.

Faleminderit!

Albana Vokshi –Faleminderit, Kejdi dhe Flolda!

Mbyllet pika e parë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.01.2019, ora 09:15

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

2. Seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, zonjën Besa Shahini, në kuadër të shqyrtimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Endri Hasa(zëvendësues) dhe Floida Kërpaçi(zëvendësues).

Mungojnë:

Romeo Gurakuqi.

Të ftuar:

Besa Shahini – Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Oltjon Muzaka – sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Redi Shtino – këshilltar i ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Fatjon Hoxhalli – këshilltar i ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Vijon pika e dytë e rendit të ditës

Milva Ekonomi- Dua të sjell në vëmendjen tuaj që ne kemi një Rregullore, e cila organizon punët e komisionit dhe në Rregullore, neni 29, i përmirësuar, tregon që rendi i ditës miratohet nga të gjithë ne, sepse të gjithë kemi rënë dakord për këtë rend dite. Në rendin e ditës së sotme ne kemi për të diskutuar ndryshimet që ka propozuar grupi i LSI-së për 4 ndryshimet në ligjin e arsimit të lartë, ku preken nenet: 37, 39, 42 dhe 48.

Në fakt, në shpjegimet që dëgjuam kishte një vështrim të përgjithshëm dhe nuk kishte të bënte me nenin. Prandaj, dua t'i bëj thirrje ministres që të fokusohet në shpjegimet e këtyre neneve, për të cilët janë bërë propozime dhe të qëndrojmë te rendi i ditës, për të cilin ramë dakord të gjithë së bashku.

Albana Vokshi – Pika e parë e rendit të ditës ishte diskutimi në parim i projektligjit, të cilin ju e përmendet. Në pikën e dytë ne kemi kërkuar dëgjuesë me ministren, e cila nuk u referohet vetëm 3 amendimeve të LSI-së, por është më e gjerë se kaq, janë problematika që ka sjellë ligji i arsimit të lartë dhe çështjet e studentëve. Meqenëse ministrja ka mbledhje qeverie në orën 11:00 dhe na u lut që ta afronim dëgjuesën me të, atëherë po shqyrtojmë kërkesën e ministres, po tregohemi tolerantë. Ne e nisëm mbledhjen në orën 9:00, pavarësisht se e kishim parashikuar pak më vonë, mbledhja do të zgjaste deri në orën 15:00 ose 16:00 dhe ministrja nuk mund të ishte në mbledhje qeveria, sepse unë mendoj se diskutimi për çështjen e studentëve për ligjin e arsimit të lartë është shumë herë më i rëndësishëm sesa aktet që mund të miratohen sot në mbledhjen e qeverisë. Prandaj, ju lutem, të mos marrim më shumë kohë, por të ftojme ministren! Nuk do të flasim vetëm për amendamentet e LSI-së, shkresa është e qartë për ligjin e arsimit të lartë, ku përfshihen edhe amendamentet e

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A mund ta mbaroj? Çfarë frike keni? Ministrja mund t'ia dalë edhe vetë. Nëse ju nuk e kuptoni që edhe amendamentet e propozuara prekin të gjithë ligjin e arsimit të lartë, unë nuk e di se çfarë t'ju them. Unë kam pyetjet e mia për ministren dhe do t'ia bëj. Kështu që, ju lutem, me skenarin që keni përgatitur bëni një hap më mbrapa, sepse ministrja do të përgjigjet për çdo shqetësim që mua dhe kolegëve të mi na ka ardhur gjithë këto ditë. Mua më kanë ardhur me dhjetëra mesazhe për t'iu adresuar ministres, edhe nga studentë që sot janë të ngujuar. Prandaj, na lini të bëjmë një dëgjuesë normale. Mos ndërhyini, sepse nuk kemi kohë, përndryshe do të detyrohemi që këtë dëgjuesë ta vazhdojmë pas mbledhjes së qeverisë. Kemi kohë të mjaftueshme për çdo kërkesë të studentëve.

Milva Ekonomi – Me kërkesën që i keni dërguar ministres, që e keni firmosur ju, zonja Vokshi, në datë 28.01.2019, shkruani: “Në kuadër të shqyrtimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” nismë legislative e deputeteve Kejdi Mehmetaj dhe Floida Kërpaçi, bazuar në nenin 38, pika 3-të të Rregullores së Kuvendit, kërkojmë pjesëmarrjen tuaj në mbledhjen e komisionit, e cila do të zhvillohet në datën 30.01.2019”. Ju keni propozuar që mbledhja të zhvillohet në orën 11:00, ndërkohë ministrja ju është përgjigjur: “Në orën 11:00 unë kam mbledhje qeverie dhe nuk mund të jem prezent, kërkoj afrim të orarit”. Prandaj ne filluam më herët. Ky është rendi i ditës i përcaktuar.

Albana Vokshi – Në fakt, vendimi nuk është kështu dhe kushdo që e ka zbardhur, e ka zbardhur gabim.

Milva Ekonomi – Është me firmën tuaj.

Albana Vokshi- Është zbardhur gabim, sepse vendimi ka qenë për të gjitha çështjet e ligjit të arsimit të lartë. Duhet të mbajë përgjegjësi ai që e ka zbardhur gabim.

Luan Baçi – Ju lutem, për procedurë.

Albana Vokshi – Luan, të lutem të mos humbim kohë, sepse këta e kanë skenar.

Luan Baçi – Meqenëse këta e kanë skenar, unë po ju them një gjë: ne do të vazhdojmë me rendin e ditës dhe nuk ka asnjë lloj diskutimi. Kush ju tha juve se do të dalim nga rendi i ditës?! Ne do të vazhdojmë me rendin e ditës.

Musa Ulqini – Zonja kryetare, së pari, këtë seancë nuk e kemi kërkuar ne, maxhoranca.

Albana Vokshi - Jo, kjo është vendosur nga mbledhja e komisionit.

Musa Ulqini - Së dyti, ne, si maxhorancë, nuk kemi bërë asnjë mbledhje për të ndërtuar ndonjë skenar.

Së treti, nëse zonja Milva ka biseduar me ju në emrin tonë dhe ju ka informuar për ndonjë skenar të mundshëm, besoj se zonja Milva mund të na japë përgjigje. Kështu që...

Albana Vokshi – Skenarët i bëni te godina përballë.

Musa Ulqini – Fjalën “skenar”, mund ta tërhiqni, sepse nuk ka skenar.

Albana Vokshi – Me skenar erdhët edhe herën e kaluar, ku donit t’i bënit të gjitha dëgjesat në orën 19:00. Ku është parë dhe dëgjuar kjo ndonjëherë?! Ju kishit përgatitur skenarin tuaj për të dështuar dëgjesat dhe diskutimin e të gjitha problematikave dhe kërkesave të studentëve. Ju lutem, na lini të vazhdojmë, sepse ministres i duhet të largohet në orën 11:00. Nëse do të vazhdoni me këto, do të kërkojmë që ministrja të rikthehet nga mbledhja e qeverisë.

Musa Ulqini – E bëra këtë ndërhyrje për t’u treguar të gjithë atyre që na ndjekin se cili është kuptimi i fjalës “skenar”, sipas jush dhe sipas asaj që është në të vërtetë. Kaq.

Albana Vokshi – Faleminderit shumë, Musa!

Luçiano Boçi – Për procedurë.

Albana Vokshi – Urdhëroni!

Luçiano Boçi – Të dy propozueset e parashtruan propozimin e tyre, e përcaktuan në kohë kur e kanë sjellë dhe dhanë mendimet e tyre.

Tani t’ia japim fjalën zonjës ministre.

Për sa i përket çështjes së kohës, në mbledhjet e qeverisë ministrja përfaqësohet edhe nga zëvendësministri, sepse po vendosim disa kufij, orare. Çfarë orarësh?! Jemi në parlament, do të vazhdojmë pa kufi. Kjo është në interesin tuaj dhe të ministres që të vazhdojmë dhe të mbarojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Këtë po them, të mos e pengojmë.

Albana Vokshi - Zonja Ministre, mbrëmë në orët e vona na keni dërguar një informacion dhe e kemi lexuar të gjithë informacionin.

Dua t’ju kërkoj shumë shkurt të na prezantoni qëndrimin e ministritë suaj, hapat që ju keni bërë në lidhje me të gjithë kërkesat, që prej fillimit të dhjetorit, nga ana e studentëve, të gjitha hapat që juve keni ndërmarrë në lidhje me këtë. Dua të kem edhe një reagim nga ana juaj në lidhje me dhunën çnjerëzore që është ushtruar ndaj studentëve brenda ambienteve universitare. Si grua nuk ju kam dëgjuar që të shpreheni në lidhje me këtë gjë. A jeni në të njëjtën linjë dhe bini dakord me ministren e Shtetit që tha: “Ata studentë që janë të ngujuar prej ditësh janë thjesht karikaturë e protestës”?

Së dyti, dua të di qëndrimin tuaj në lidhje me deklaratën e asamblesë së pedagogëve. Për dy ditë mbaron afati dhe ata kanë shtuar edhe 4 kërkesa, që kanë lidhje me kërkesat e studentëve. Pra, ju lutem, shumë shkurt në lidhje me këtë, sepse dhjetëra mesazhe më kanë ardhur vetëm mbrëmë, të cilët më kërkojnë t’ua përcjellim juve.

Besa Shahini – Faleminderit!

Sot gjendem për herë të parë para jush në detyrën e ministres, edhe pse jemi takuar gjatë vitit të kaluar, kur kam shërbyer si zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe kryesisht kam mbuluar sferën e arsimit parauniversitar.

Falënderoj deputetet për këtë nismë, që na kanë mundësuar neve të japim mendimin tonë dhe të fillojmë një diskutim të frytshëm për më të mirën e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Për sa i përket propozimit konkret, për të cilin jam ftuar sot këtu, ai ka të bëjë me një nismë ligjore për ndryshimin e 4 neneve në ligjin “Për arsimin e lartë”.

Po bëj një përmbledhje, meqenëse nuk është bërë nga parafolëset: këto katër ndryshime kërkojnë rritjen e përfaqësimit të studentëve nga masa 10% në 50% në senatet e universiteteve, njëkohësisht rritjen e përfaqësimit të studentëve nga masa 10% në 50% në organet e tjera, që vendosin për zgjedhjen e dekanëve dhe rektorëve, si dhe një përfaqësues nga studentët te bordet e menaxhimit.

Do të kaloj shkurt në këto 4 pika.

Senati i universitetit ka një detyrë specifike, që të zhvillojë funksione garantuese në lidhje me lirinë akademike dhe autonominë e tyre, propozon plane strategjike të zhvillimit të universitetit, miraton statutin e institucionit të arsimit të lartë...

Albana Vokshi – Më duhet t’ju ndërpres, mos na lexoni funksionet e senatit, ju lutem, nuk kemi nevojë! Kini pak respekt, sepse jemi ligjvënës.

Milva Ekonomi – Mos ia ndërprisni fjalën zonjës ministre, por lëreni të flasë.

Albana Vokshi - Me gjithë respektin për zonjën ministre, por nuk kemi nevojë për këtë!

Milva Ekonomi – Zonjat Mehmetaj dhe Kërpaçi...

Albana Vokshi – Zonja ministre i dimë funksionet e senatit, amendamentet na i sqaruan, duam vetëm përgjigjen e ministrisë. Ju lutem, ju kam bërë dy kërkesa për prononcime nga ana juaj. Mos na i lexoni funksionet e senatit, nuk duam t’i dime; kush nuk i ka lexuar, le t’i lexojë te ligji.

Ju lutem, kaloni direkt, sepse u prezantua nisma nga ana e deputeteve! Mos më detyroni t’ju ndërpres përsëri.

Besa Shahini – Unë do të vazhdoj t’i lexoj për shkak se është e rëndësishme, edhe për ata që po na shikojnë nëpërmjet televizioneve se cilat janë funksionet e senatit, pra çfarë bën një organ aq i lartë vendimmarrës në një institucion të arsimit të lartë. Do t’i përmbledh shkurt, prandaj, ju lutem, më jepni vetëm 10 sekonda.

Pra, harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë, miraton rregulloret e institucionit dhe aktet e tjera, miraton programet e reja të studimit dhe të kërkimit shkencor, paraprakisht miraton planin buxhetor vjetor dhe afatmesëm, zgjedh përfaqësuesit e tij në bordet e administrimit IAL-ve e të tjera. Pra, është një organ, i cili kërkon një lloj ekspertize të posaçme që studenti nuk e posedon.

Për të qenë pjesëtar në një senat, duhet të kesh një gradë shkencore, profesor apo doktor, dhe personat duhet të kenë studiuar diku në një vend të Bashkimit European apo

OECD-së. Në rast se kjo nuk disponohet në universitetin në fjalë, atëherë, sipas rregullores së brendshme të universitetit, mund t'u lihet kjo hapësirë edhe personave që kanë studiuar në Shqipëri. Pra, po flasim për një organ vendimmarrës, ku ekspertiza duhet të jetë në një nivel shumë të lartë. Ne i pamë të gjitha rastet në universitete të ndryshme, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në BE dhe në OECD-së, ku u munduam të shikojmë se në cilin rast ka një përfaqësi aq të lartë të studentëve në organet e vendimmarrjes dhe nuk e hasëm asnjë rast të tillë. Pra, nuk ka një vend, një universitet, ku studenti përfaqësohet në masë 50% në senat. Fryma e përfaqësimit të studentëve në senat është që të sigurohet transparencë dhe llogaridhënie. Pra, nuk është fryma që studenti të jetë pjesë e vendimmarrjes. Natyrisht, në masën ku përfaqësohet studenti, ai merr edhe vendime. Qëllimi i prezencës së studentëve nuk është ai nga ato që pamë nëpër universitete të ndryshme në shtete të ndryshme, konkretisht të vendeve të BE-së. Ka dallime nga universiteti në universitet, pra nuk ka rregulla të përgjithshme, që, për shembull, në Gjermani, në të gjitha universitetet, të ketë një masë të caktuar të përfaqësisë. Këto janë vendime që i merr universiteti në nivel universiteti dhe në asnjë rast nuk është i përfaqësuar studenti në masën 50%.

Për sa u përket vendimmarrjeve për dekan dhe rektor, pra personat që janë përfaqësuesit më të lartë të njësive apo edhe të gjithë universitetit, përsëri këtu ekziston një problem, se nëse studentët janë në masë 50% të vendimmarrje, kush do të ngrihet në atë detyrë, për shkak se studentit i kërkohet një ekspertizë që të vendoset se kush do të udhëheqë me universitetin dhe me njësinë, kërkohet që të ruhet marrëdhënia pedagog-student, që nuk mund të ruhet në rast se studenti vendos se kush do të bëhet dekan dhe kush do të bëhet rektor në masën 50%. Ne i pamë të gjitha rastet në vende të ndryshme të BE-së dhe nuk e pamë një model, që i mundëson studentit të ketë një lloj vendimmarrje të tillë. Studenti futet dhe del nga universiteti, pra nuk qëndron aty për një kohë të gjatë. Për shembull, ai bën 3 vjet *bachelor* dhe 2 vjet master, dhe nuk mund të jetë vendimmarrës për ata që do të jenë udhëheqës, përtej kohëzgjatjeve që studenti është me studime.

Kalojmë te pika 4, e cila ka të bëjë me bordin e menaxhimit. Logjika e themelimit të bordeve është se ata që financojnë, përfaqësohen më shumë nëpër borde, pra aty ku universiteti ka arritur që të ngrejë sfonte të tijat, ka një përfaqësi me shumicë në bord, aty ku qeveria mbulon pjesën kryesore të shpenzimeve, pra, ka një shumicë të përfaqësisë në bord. Ne, për hir të transparencës dhe llogaridhënies, ngaqë u ngrit edhe nga studentët, kemi marrë një vendim në dhjetor, ku do të shkarkojmë të gjithë përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë që janë nëpër borde, në mënyrë që të bëjmë një proces të ri të zgjedhjeve, një proces tërësisht transparent. Javën e kaluar u kemi bërë edhe ftesë publike që të aplikojnë persona që

janë public, me integritet, që do të shërbejnë në këto borde dhe një nga përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të zgjidhet nga vetë studentët. Pra, do t'i plotësojë të njëjtat kritere që plotësojnë të gjithë të tjerët, por zgjedhjet do të bëhen në nivel universiteti dhe studentët do të kenë mundësi të çojnë tri kandidatë, të preferuarit e tyre, që më pas do të vendoset në bord si përfaqësues i studentëve, që të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie në pjesën e vendimmarrjes më të lartë për të siguruar mirëmenaxhimin financiar të universiteteve.

Së dyti, një vendim shumë i rëndësishëm është se kemi themeluar atë që ne e quajmë “portali i transparencës”, i cili do të bëhet funksional brenda 2 muajve të ardhshëm, ku do të botohen të gjitha vendimet e senateve, të gjitha vendimet e organeve më të larta udhëheqëse dhe të gjitha buxhetet, në mënyrë që edhe studentët, që nuk janë të përfaqësuar nëpër këshilla studentore apo në senat, mund të marrin pjesë në vendimmarrje për universitetet e tyre, duke qenë të mirinformuar. Çdo 3-4 muaj ky informacion do të azhurnohet dhe të gjithë do të kemi të njëjtën qasje në të njëjtin informacion, që mos të ketë më dilema se si shpenzohet buxheti për universitetet.

Universiteti i Korçës na ka sjellë një letër para 2-3 ditësh, ku ka vendosur përfaqësuesit e universitetit në bord; ata do të mundësojnë që përfaqësuesit e këshillit studentor të jenë në bord. Pra, edhe ky është një model është në tagrin e universitetit ta bëjë, që mund të ndiqet edhe nga universitetet tjera, nëse e shikojnë të domosdoshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Zonja Kumbaro, po e drejtoj unë mbledhjen dhe e mbaj unë qetësinë, mos ndërhyri, sepse po ndërprisni ministren.

Mirela Kumbaro – Kërkova vetëm respekt të fjalës. Kërkova të njëjtën gjë.

Albana Vokshi - Nuk jeni juve këtu, jam unë. Kur të vini këtu, atëherë bëjeni si ju.

Mirela Kumbaro – Unë këtu e thashë, nuk erdha aty.

Albana Vokshi - Po jua tërhiqja unë vëmendjen. Nuk ka nevojë me kaq nerva, e dimë se jeni të mërzitura, por na lini të dëgjojmë ministret e reja, t'i respektojmë!

Besa Shahini – Faleminderit!

Një gjë që doli shumë qartë nga protesta e studentëve, ishte pakënaqësia që studentët shfaqën me udhëheqjen që kanë universitetet, por edhe pakënaqësia me përfaqësimin që ata kanë. Mendoj se duhet, kjo nuk na takon ne, por duhet ta diskutojmë këtu, sa më parë që të jetë e mundur të organizohen në nivel universiteti zgjedhjet për këshillat studentorë, që studentët të ndihen sa më të përfaqësuar në këshillat studentorë. Ky është një zinxhir, pra në fillim janë përfaqësues në këshillat studentore, më pas janë përfaqësues në senat dhe që studentët të ndihen

të përfaqësuar, duhet që të kenë personat që i respektojnë dhe mendojnë se përfaqësojnë më së miri interesin e studentëve.

Së dyti, është në tagrin e universitetit që të bëjë zgjedhje të parakohshme, nëse e shikon të nevojshme, për organet më të larta drejtuese. Përsëri, kjo nuk është diçka që vendoset nga ne apo nga ju këtu, por po e hedh në diskutim këtu, që të reflektojnë edhe universitetet, nëse ata e shikojnë të arsyeshme që të bëjnë zgjedhje të parakohshme një vit më pare, ngaqë e kanë në vitin 2020, t'i bëjnë në vitin 2019 dhe të mundohen që në njëfarë mënyre të plotësojnë këtë kërkesë që doli nga protesta e studentëve, për një përfaqësim më të mirë apo për një udhëheqje më të mirë të universiteteve.

Duke marrë parasysh këto që thashë, si dhe duke marrë parasysh të gjitha çfarë kemi parë nga shtetet e tjera si modele, ne nuk e shikojmë të domosdoshme që këto ndryshime të adresohen përmes ndryshimeve ligjore. Po ashtu, duhet marrë parasysh se me vendim të Këshillit të Ministrave në dhjetor, dy nga çështjet kryesore që ndritën studentët: transparencën dhe llogaridhënien, dhe përfaqësimin nëpër borde, i kemi adresuar.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Atëherë qëndrimi i ministrisë ndaj propozimeve është kundër.

Ju po pranoni që pakti nuk i paska plotësuar kërkesat e studentëve. Pse Kryeministri Rama dhe ju dilni nëpër konferenca shtypi dhe vazhdoni mashtroni, ku thoni se pakti i paska adresuar kërkesat e studentëve? Ia ku i kemi kërkesat e studentëve. Ju vini këtu në mënyrë zyrtare thoni: “jo, jemi kundër”. Pse vazhdoni të mashtroni studentët që janë ende të ngujuar?! Ju vetë, në këtë sallë, po pranoni se nuk i keni përmbushur. Po vini zyrtarisht dhe thoni se jeni kundër disa prej kërkesave të studentëve. A është në nderin tuaj si ministre e re, zonja Ministre, të vini dhe të vazhdoni me mashtrimet tuaja për paktin, që i keni plotësuar?! Mua më vjen shumë mirë që ju pranuat vetë me gojën tuaj, që nuk janë plotësuar, por në nderin tuaj është që të dilni dhe t’ju thoni të gjithë pedagogëve dhe të gjithë studentëve “nuk mundemi, nuk i kemi plotësuar as tarifat, nuk kemi plotësuar as disa prej kërkesave që Kejdi dhe Floida i kthyen në propozime ligjore”.

Besa Shahini – Edhe një herë, propozimet ligjore nga dy deputetet ishin për përfaqësimin e studentëve në masën 50%...

Albana Vokshi – Është kërkesë e studentëve, e shkruar në formë amendamenti ligjor, që ju e hodhët poshtë. Kjo është kërkesë e paplotësuar. Ju, zyrtarisht sot, po pranoni se pakti është një mashtrim, që ju i keni mashtruar deri më sot studentët. Po e pranoni me gojën tuaj. Keni mashtruar në disa kërkesa të studentëve, nuk i keni plotësuar. Më vjen mirë që e pranuat!

Ju lutem, prononcimin tuaj për dhunën dhe për deklaratën e asamblesë që, më pas, t'ua kaloi fjalën edhe kolegëve!

Besa Shahini – Përkundrazi, ajo që thashë është se pakti i ka adresuar këto kërkesa të studentëve dhe nuk kemi nevojë të bëjmë ndryshime ligjore. Kjo është ajo që thashë pak më parë.

Për çështjet e tjera, nëse doni që të bëjmë dëgjese më të gjatë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me arsimin e lartë, ta organizojmë në mënyrë të rregullt, duke më sjellë një kërkesë për dëgjese. Unë sot kam ardhur të diskutoj ndryshimet ligjore.

Albana Vokshi – Zonja Ministre, a jeni ju dakord me dhunën e ushtruar brenda ambienteve universitare? Ju duhet të prononcoheni, sepse jeni ministre, nuk mund t'i shmangeni detyrës suaj. Nuk do të prononcoheni për dhunën, ashtu siç nuk e keni bërë deri më sot?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, prisni, sepse është deklarata e asamblesë së pedagogëve. Mbaron afati për dy ditë. Ju kanë vënë katër kushte, përndryshe ata do të përshkallëzojnë protestën, do të futen në grevë. Këto lidhen edhe me amendamentet që ka sjellë LSI-ja sot këtu.

Besa Shahini – Nëse doni që të bëjmë dëgjese, unë e mirëpres ftesën me shumë dëshirë, që edhe një herë të vij këtu dhe të bëjmë një dëgjese të mirëfilltë për arsimin e lartë dhe për të gjitha çështjet që ngritët. Pra, me shumë dëshirë do të vij në një moment të dytë, kur të më dërgoni ftesën. Më keni dërguar ftesë për katër amendamentet ligjore, që kanë qenë propozim i deputeteve të LSI-së.

Albana Vokshi – Cilën pikë nuk kuptoni nga këto që unë po ju them? Asambleja e pedagogëve ka lidhje me ndryshimet. Cilën pikë nuk kuptoni? Njëra pikë ka lidhje me autonominë, tjetra ka lidhje me lirinë akademike, pra kanë lidhje me të gjitha propozimet që ka bërë LSI-ja. Cilën pikë nuk kuptoni ju, që lidhen njëra me tjetrën?

Besa Shahini – Edhe një herë, më keni ftuar të jap mendim për nismën ligjore, të cilat unë i ezaurova. Nëse keni dëshirë të bëjmë një dëgjese për arsimin e lartë, do të vij me shumë dëshirë në një moment të dytë, kur të më dërgoni ftesën.

Albana Vokshi – Ju lutem, zonja Ministre, tregoni që dini diçka, meqenëse është dalja e parë! Ju lutem, dilni pak nga korniza, mos shërbeni kaq shumë!

Urdhëroni!

Kejdi Mehmetaj – Kjo pjesa tani m'u duk: “nuk flas pa praninë e një avokati”!

Zonja Ministre, unë prisja që të paktën sot, siç e thatë edhe ju, meqenëse është hera e parë që vini në këtë komision në rolin e ministres, të kishit ardhur, pa dashur t'ju ofendoj, pak

më e përgatitur. Të paktën për nenet që ne kemi propozuar, argumentet t'i kishit sjellë më serioze, më ligjore dhe, mbi të gjitha, të reflektonit në sytë e studentëve, që me siguri ju dëgjojnë sot, që keni minimumin e dëshirës për të realizuar një pjesë të kërkesave të tyre. Të jem e sinqertë, personalisht, si një prej propozueseve, do të isha ndjerë shumë mirë, edhe do t'ju mbështesja 100%, sikur të thoshit: “dëgjo, ne 50% na duket e paarsyeshme, por të paktën nga 10%, le ta çojmë 11%.” Të mos harrojmë që në ligjin para këtij, studentët përfaqësoheshin me 20%, qoftë në senatin akademikë, qoftë në përzgjedhje e kështu me radhë. Në asnjë rast, nuk besoj se ju e njihnit realitetin e Shqipërisë në atë kohë, nuk është krijuar qoftë edhe një problem i vetëm në universitete, si pasojë e përfaqësimit të studentëve. Përkundrazi, ata kanë ndihmuar, dhe kemi qenë të pranishëm, sepse kemi qenë edhe vetë studentë, që në krye të universiteteve të jenë personazhe të përgjegjshëm dhe me dinjitet, sepse askush më shumë se studenti nuk e di se sa e rëndësishme është që përballë në auditor të ketë një pedagog serioz, një pedagog të komunikueshëm dhe që studentin e ka në fokusin e punës së tij. Kështu që minimumi që mund të bënit ju sot, në gjykimin tim, është që t'u thoni studentëve nga këtu: 50% mbase është shumë, dhe mund të jetë shumë, por ama ne kemi një premisë për të marrë vendoshmërinë tuaj për të qenë pjesë e asaj që ndodh në universitet, edhe për të lëvizur diçka, qoftë edhe duke parë secilin nen më vete dhe duke bërë kërkesa të arsyeshme për secilin prej tyre.

Megjithatë, atë që studentët morën qartazi nga ju sot, është se ju nuk jeni fare me ata dhe nuk keni asnjë qëllim të zgjidhni kërkesat e tyre.

Albana Vokshi – Të lutem, Kejdi, sepse e more kohën tënde!

Kejdi Mehmetaj – Jo, do të bëj vetëm disa pyetje.

Unë i mbajta shënim fjalët që thatë ju dhe po i them ato fiks siç ju i thatë. Thatë se studentët janë, me 10%-shin e tyre, për llogaridhënie dhe transparencë dhe nuk kanë rol vendimmarrës. Këto thatë fjalë për fjalë, hapini, kthejini, dëgjojini. Zonja Ministre, a e keni lexuar ligjin “Për arsimin e lartë”, sepse në qoftë se keni lexuar, aty flitet për vendimmarrje.

Së dyti, ju thatë që studentët nuk kanë kompetenca për të pasur 1% më lart në vendimmarrje. Më falni, sa kompetentë janë në ministrinë tuaj, si jeni vlerësuar ju, me çfarë gradash shkencore, që ju paskeni tagër për të vlerësuar, meqenëse nxorët VKM-në për vlerësimin e pedagogëve, ndërkohë që studentët nuk e paskan këtë aftësi?

Në dijeninë në time në ministrinë tuaj ka edhe nga ata që mund të jenë me dyshime për çështje diplomash, nuk kanë tituj akademikë, janë të dalë nga bankat e shkollave, dhe shumë mirë se nuk mund të jenë të gjithë me tituj, me tituj duhet të jenë profesorët, por si e vlerësoni ju që brenda jush paska kompetenca shumë të mëdha, ndërsa studentët nuk i paskan fare këto

kompetenca? Pastaj thatë një transparencë për bordin çdo 3-4 muaj dhe një azhornim. Ku qëndron transparenca nëse bën azhornimet 3-4 muaj? Këtë nuk kam për ta kuptuar dhe, më besoni, asnjë student.

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Mehmetaj!

Të lutem, se keni marr shumë kohë!

Kejdi Mehmetaj - E fundit, thatë të bëhen zgjedhje të parakohshme nëpër universitete, sepse kjo e zgjidh situatën.

E dashur, zonja Ministre, në atë kohë zëvendësministre, studentët nuk dolën të protestonin përballë pedagogëve të tyre, erdhën përballë ministrisë suaj. Meqenëse ju paska shkuar në mendje kjo zgjedhja e parakohshme, si zgjidhje e situatës, pse nuk i thoni Kryeministrit që ka ardhur momenti që të kemi zgjedhje të parakohshme, se problemi i studentëve jeni ju, Ministria e Arsimit, qeveria dhe jo pedagogët. Ata janë bashkë në një zë sot. Prandaj këtë pyetje ju ftoj ta merrni me vete, meqenëse keni mbledhje qeverie sot dhe nuk keni kohë të flisni për studentët, bëjani Kryeministrit me të njëjtin tonalitet që e bëtë edhe sot. Të fajshëm jeni ju dhe jo universiteti!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Baçi!

Luan Baçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, dua të shtroj dy probleme:

Së pari, për mendimin tim, më duket diskutim pa sens. Edhe sikur kolegët e maxhorancës të votonin pro amendamenteve të kolegeve të LSI-së, unë do të votoja kundër. Nuk do të isha pro miratimit të atyre amendamenteve për një arsye të vetme: amendamentet nuk zgjidhin problemet e ligjit. Ligji ka probleme në tërësi dhe duhet parë në tërësi. Për mendimin tim, jo pa qëllim kolegët e maxhorancës ngulin këmbë për qëndrimin brenda rendit të ditës vetëm për pikat e amendamenteve. Ky është një diversion që ne u bëjmë studentëve dhe kërkesave të pedagogëve. Në qoftë se do të binim dakord t'i miratonim këto amendamente, pra të bien dakord edhe kolegët e maxhorancës, vinim në seancë dhe e zgjidhjmë problemin e arsimit të lartë. Absolutisht jo, të paktën qëndrimi i Grupit Parlamentar të PD-së është i tillë dhe ruan linjën e partisë sime. Mendimi im personal është që ne duhet të qëndrojmë këtu, pra të rishikojmë ligjin e arsimit të lartë, duke marrë parasysh të gjitha kërkesat e studentëve dhe të pedagogeve.

Kemi një listë kërkesash të asamblesë së pedagogëve drejtuar qeverisë, ministrisë, të cilat presin përgjigje deri në datën 1 shkurt dhe kanë thënë se do të hyjnë në grevë, pra ne do të jemi në mbështetje të kërkesave të pedagogëve. Edhe kërkesat e studentëve janë të

pasqyruara te “pakti për universitetin”, aq më tepër te propozimet e pjesshme që mund të bëjmë ne, si opozitë. Pra, në këtë drejtim më mirë që diskutimi i sotëm është i shkurtër dhe më mirë që ministrja ka mbledhje qeverie dhe do të ikë, për arsye se nuk do të zgjidhte asgjë, edhe nëse ne do të binim dakord me ato amendamente. Duke përfutur nga rasti, meqë zonja ministre është sot këtu, duke i uruar edhe detyrën e re si ministre, megjithëse një shkallë ka ngritur, nga zëvendësministre u bë ministre dhe është në brendësi të shumë problemeve të arsimit, po i them se e ka nisur keq detyrën.

Midis të gjithë problematikës që ka arsimit, jeni shprehur edhe për bursat që do të shpërndani ju, si ministri dhe si qeveri. Më vjen keq t’ju them, por po e shkelni ligjin me të dyja këmbët. Shpërndarja e bursave është atribut i bashkive dhe i këshillave bashkiakë, nuk është e drejtë e ministrisë apo e qeverisë. Ka një kategori studentësh që përfitojnë nga bursat. Kjo kategori studentësh gjithmonë do të rishikohet, do të trajtohet nga bashkitë dhe nga këshillat bashkiakë, të cilët jo pa qëllim e kanë të drejtë shpërndarjen e bursave, madje nuk e ka as kryetari i bashkisë, pasi këshillat bashkiakë kanë në përbërje forca të ndryshme politike. Ata bëjnë listat, kanë të dhënat e të gjithë familjarëve që nuk plotësojnë kushtet e nevojshme të domosdoshme nga ana financiare. Pra, këshillat bashkiakë do të merren me hartimin e listave, pastaj do t’ju delegojnë juve që të bëni shpërndarjen e bursave. Përse duhet të bëjnë një rrugë të gjatë që këta emra të studentëve, që përfitojnë bursa, t’i shpërndani ju? Pyetja është retorike dhe nuk ka nevojë për përgjigje fare, sepse e njoh shumë mirë situatën si veprohet, pra futemi në një vit elektoral dhe ju duhet ta shfrytëzoni këtë për të bërë shpërndarjen e tyre, shumë herë për të bërë ndryshimet e emrave sipas qejfit dhe oreksit tuaj, këtë e them nga informacionet e plota që kam. Kjo është një shkelje e ligjit me të dyja këmbët. Ndoshta ju, zonja Ministre, nuk e keni problem ta shkelni ligjin, se mund ta lini vendin e punës menjëherë. Ky është i gjithë faji juaj. Në qoftë se do të kapet kjo gjë nesër, të jeni e sigurt që do të jetë objekt i punës së opozitës dhe i organeve kompetente.

E dyta, ka një rreth një javë, zonja Ministre, dhe kjo nuk lidhet me ardhjen tuaj si ministre, ndoshta edhe më shpejt, që të gjithë mësuesve në përgjithësi po u kontrollojnë *Facebook*-un dhe rrjetet e tjera sociale. Sot njerëzit janë shumë të lexueshëm, sepse komentojnë, japin pëlqime apo kanë shfaqur qëndrimin e tyre në rrjetet sociale pro ose kundër politikave të qeverisë dhe të ministres apo të ministrave të tjerë. Edhe për këto ka fakte e denoncime konkrete dhe flas për qarkun e Fierit. Absolutisht, ndoshta në vazhdimësi do t’ju vë përpara edhe fakte konkrete për presione ndaj mësuesve për vendet e punës dhe presione të tjera të kësaj natyre.

Sinqerisht, dua të them se duhet të ndërhyni me kompetencën tuaj të ministres që raste të tilla të ndërpriten, të mos vazhdojnë, sepse janë të dënueshme dhe aspak të pranueshme për situatën ku jemi.

Luçiano Boçi – Së pari, i uroj suksese ministres për detyrën e ngarkuar! Sinqerisht, e kuptoj vështirësinë e detyrës. Ministrja është marrë më parë me arsimin parauniversitar, por ka shumë ndryshime midis politikave që zhvillohen në arsimin e lartë dhe në arsimin parauniversitar. Gjithsesi, një staf i përgatitur mund ta ndihmojë mirë ministren dhe ajo vetë duhet të jetë shumë e kujdesshme në atë që transmeton qoftë në medie, qoftë edhe komunikimin parlamentar. Unë e dëgjova me vëmendje ministren.

Në fakt, fjalën time dua ta nis me një klasifikim të dalë nga një organizëm ndërkombëtar “*World Map*”, i cili trajton inteligjencën në vendet e BE-së dhe në botë. Për inteligjencën Shqipëria renditet e parafundit në Europë dhe ka lënë pas vetëm Bosnje - Hercegovinën. Këtu nuk e kam fjalën për inteligjencën natyrale të shqiptarëve, sepse ajo është tashmë e njohur botërisht, por për inteligjencën e kultivuar dhe, sigurisht, nuk po flas për inteligjencën artificiale që është duke shpikur Kryeministri ynë i nderuar. Inteligjenca e kultivuar vendoset, rritet ose financohet nëpërmjet sistemit arsimor në tërësi, atij parauniversitar, sidomos të arsimit të lartë. Arsyeja kryesore që Shqipëria renditet në këtë vend është mungesa e financimit të arsimit në dy aspekte: në sasi dhe në cilësi. Në raport thuhet se financimi i arsimit për Shqipërinë është vetëm 56 dollarë për frymë, pra jemi vendi i parafundit në Europë. Arsyeja kryesore është se kjo ka vazhduar për vite të tëra. Pikërisht nëse e lidhim me situatën e sotme, me kërkesat e studentëve, përtej “fluturimeve” që fajin e kanë pedagogët, që e kanë instancat drejtuese të universiteteve, ky është problemi kryesor i arsimit të lartë në Shqipëri: mungesa e financimit të tij. Kërkesa jonë e vazhdueshme për 5% është ajo kërkesa ulëritëse e studentëve për financimin e universiteteve publike, që ata të mos degradohen dhe të mos denigrohen. Kërkesë e tyre është që të mos paguajnë tarifën marramendëse që paguajnë sot, të detyruar nga mungesa e financimit të arsimit të lartë në Shqipëri. Ky është thelbi i çështjes dhe i protestës studentore, duke i bashkëngjitur edhe ligjin e mbrapshtë të arsimit të lartë, i cili pengoi, në qoftë se ka pasur dëshira, edhe financimet e mëtejshme të arsimit të lartë, sepse i la universitetet publike në një luftë të ashpër në tregun e universiteteve, për t’u përplasur për sigurimin e të ardhurave të tyre, për të siguruar të paktën pagën e pedagogëve. Në këtë gjendje mjerane janë sot universitetet dhe kanë ndërtuar konfliktin e paparë ndonjëherë në Shqipëri midis trupës akademike dhe studentëve, siç ju kërkoni ta paraqisni, dhe, në fakt, ekziston, por në terma të tjerë, sepse studenti trajtohet si klient, i merren vetëm paratë, dija

është gjysmake, nuk është ajo dija e famshme që transmetohej dikur dhe palët janë të pakënaqur, pagat e pedagogëve janë të ulëta dhe trajtimi i studentëve është mizerabël.

Thashë në fjalën time që stafi duhet të jetë shumë i kujdesshëm. E di shumë mirë që raportin jua ka përgatitur stafi dhe arsyetimi juaj nuk qëndron, sepse ka shumë kontradikta në parashtrim. Së pari, në materialin e shkruar, pasi ju nuk e transmetuat këtu, pretendoni se universiteti ka dy cikle studimi dhe përdorni si argument faktin se studenti nuk mund të jetë gjatë përfaqësues në senat, sepse ai ka një kohë të shkurtër në dispozicion. Jo, institucioni i arsimit të lartë është me tri cikle studimi, por ju keni të drejtë, sepse ka tre vjet që nuk ka doktoratura dhe ju i trajtoni me dy cikle studimi. Në qoftë se ju i lini ende me dy cikle studimi, sot institucionet e larta në Shqipëri, në pjesën më të madhe të tyre, nuk meritojnë emërtimin universitet, por janë vetëm kolegje, sipas përcaktimeve ligjore që ju keni.

Lidhur me arsyetimin tjetër që jepni për trupën e studentëve në raport me trupën akademike, jam shumë dakord që trupa akademike është vendimmarrëse edhe në senat, edhe në bordin e administrimit, që ka edhe ekspertizën e duhur, por trupa akademike është nominale, me karrierë akademike, ndërsa trupa studentore nuk është nominale. Ju nuk mund ta trajtoni kalimtare trupën studentore dhe kjo është gafa juaj e madhe. Studenti është student. Edhe në qoftë se është në vitin e tretë, ai përfaqëson studentët e të gjitha cikleve. Në qoftë se është student që mbaron ciklin, ka përfaqësuar interesat e studentëve që kanë ikur dhe të atyre që do të vijnë. Studentët e sotëm, që janë ngritur në protestë dhe janë në vitin e fundit të studimeve të tyre, nuk janë për interesin e tyre, por për interesat e studentëve. Studenti është i gjithëkohshëm, mos e ngatërroni këtë gjë. Ato që sillni ju janë argumente profane, nuk janë argumente ligjore.

Propozuesit i kanë tërhequr sot kërkesat e tyre, sepse kërkojnë ndryshime shumë më të thella ligjore, në kuptimin që nuk mund të avancojnë dhe nuk do të debatojnë për këtë kërkesa nëse do të jenë 10% apo 50%, pasi gjykoj se ndryshimet e domosdoshme ligjore duhet të prekin jo vetëm pozicionin e studentëve, të meprizuar brenda institucionit të arsimit të lartë, por edhe të gjitha pozicionet e tjera, duke filluar nga pedagogu dhe duke vazhduar më pas edhe me pozitën e vetë universiteteve. Në qoftë se ju mendoni që ai pakti i famshëm do të realizohet me frymën e shenjtë, e keni gabim, sepse ju paktin po e bëni “hajde të bisedojmë, të bëjmë ca llafe dhe ta kalojmë”. Jo, paktet janë zgjedhore në radhë të parë. Nuk është koha e pakteve, ka mbaruar ajo kohë dhe veprimi i një qeverisjeje është veprimi ligjor, ndërhyrja ligjore. Nuk mund të thuash “do ta bëjmë, ne jemi të dakordësuar dhe do të vazhdojmë ta gjykojmë”! Aktet e një qeverisjeje nuk janë akte fjalësh. Aktet e fjalëve kanë mbaruar, janë veprat. Veprimet e një qeverisjeje janë propozimet ligjore. Prandaj edhe propozimi i LSI-së në këtë rast është

shumë serioz, të cilin ju nuk e morët në konsideratë. Në fakt, do të ishte një varkë shumë e mirë shpëtimi për ju në ato momente, por nuk e kuptuat situatën dhe e refuzuat. Mënyra se si ju i trajtoni zgjedhjet në universitete, dhe këtë e kam për stafin tuaj, e kuptoj vështirësinë, është tepër skandaloze, sepse zgjedhjet, zonja Ministre, rregullohen me rregulloren e zgjedhjeve. Nuk ka zgjedhje të përkohshme. Nuk e vendos vetë universiteti. E keni gabim. Rregullorja e zgjedhjeve përcakton në termat e saj ligjorë “zgjedhje të pjesshme”. Janë të pjesshme në rastet kur dekani apo drejtuesi i departamentit shkarkohet, hiqet. Madje, ka një klauzolë që titullari i institucionit, qoftë rektori, qoftë senati, qoftë dekani mund të komandojë një person dhe brenda 6 muajve realizohen zgjedhjet. Si mund të flisni ju për një gjë që nuk ekziston? Si mund të dalë universiteti të thotë se unë do të bëj zgjedhje të parakohshme? E keni gabim. Rregullorja e zgjedhjeve hartohet nga ministria, e bëni ju rregulloren, e ka ligji i arsimit të lartë. Prandaj ju thashë që ta lexoni me kujdes, të paktën specialistët t’jua sjellin tamam kuadrin ligjor dhe interpretimin e tij.

Për sa i përket gjoja transparencës ndaj buxheteve dhe vendimeve të senateve apo dekanateve, nuk mund ta bëni ju, sepse vetë universitetet kanë faqet e tyre *web* dhe e kanë të detyruar në rregulloret dhe në statutet e tyre që të paraqesin të gjitha vendimet e marra të dekanatit, të senatit, të rektoratit, të departamenteve, sikurse edhe të bordit të administrimit, pra transparencën që pretendoni se po e bëni ju, e bën vetë universiteti, sepse ai është autonomi, në atë pak autonomi që i keni lënë.

Shqetësimi që duhet të diskutojmë sot, përtej këtyre akteve, e tha edhe drejtuesja e komisionit, është akti i ndërhyrjes së policisë në ambientet e universitetit. Ne dje, nga retorika politike, bëmë një gabim të vogël dhe thamë se është i paprecedent. Jo, është i precedent, sepse ka ndodhur edhe një herë tjetër në vitin 2015, fiks në Fakultetin e Mjekësisë, tek Infermiera, kur u nxorën me dhunë, duke thyer edhe xhamat e universitetit, studentët grevistë që nuk pajtoheshin me tarifat e larta të vendosura nga ministria, për shkak të transferimeve nga universitetet private në vitin 2015. Ai ishte rasti i parë në historinë e demokracisë shqiptare dhe tani rasti i dytë është në Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin Juridik. Në fakt, jemi në alarm. Ky duhej të ishte shqetësimi ynë kryesor, krahas ndryshimeve të tjera, se po flasim për propozime studentësh. Ndërkohë, studentët janë dhunuar. Unë jam dakord që retorika politike ka ngjyrën e vet dhe duket sikur ne e frymë problemin. Jo, me shumë qetësi do të thosha se është akti më i rëndë që ka ndodhur ndonjëherë në arsimin e lartë shqiptar në këto vite. E kanë bërë krahasimin edhe me diktaturën, por policia e atëherëshme nuk ka guxuar të futet në ambientet e universiteteve dhe të konvikteve. Ka ndodhur në vitin 2015 dhe po ndodh tani. Unë

mendoj se ju, si ministry, duhej të ishit në emergjencë totale, duhej të kishit bërë prononcimet tuaja dhe sot duhej të kishit ardhur me një zgjidhje para këtij komisioni parlamentar.

Prandaj, për sa i takon pjesës së arsytetimeve, sinqerisht kërkoj të mos futemi në këto arsytetime, sepse janë shumë gabim. E kuptoj rëndesën e detyrës, por e them me sinqeritet, më besoni se nuk e kam në sens ironie, por do të doja që këto arsytetime që sillni këtu te ne, të kenë ekspertizën, që ju e kërkonin nga studentët; të kenë ekspertizën ligjore nga stafi juaj dhe të mos keni aspak dyshime tek aftësia vendimmarrëse e studentëve për kurrikulat, për programet, për shpenzimet financiare, sepse janë aq inteligjentë dhe të përgatitur, sa kanë edhe kompetencën që të jenë anëtarë senati, të marrin vendime dhe të jenë anëtarë të bordit të administrimit.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Para se t'ia kaloj fjalën Musait, më ka ardhur një kërkesë nga përfaqësues të asamblesë së pedagogëve për t'i kujtuar ministres... Zonja Ministre, e kam me ju, a mund ta lini pak celularin, se jeni para deputetëve të Kuvendit? Nuk mund të ketë ndonjë gjë më të rëndësishme për të diskutuar sesa për çështjen e studentëve. Është fytyrë kjo që po bëni, ndaj, ju lutem, kini pak vëmendje dhe respekt...

Milva Ekonomi – Të lutem, kryetare e seancës, mos ju drejtoni me atë ton ministres, sepse ajo është shumë e vëmendshme dhe po i merr shënim të gjitha gjërat që po themi...

Albana Vokshi – Jo, të lutem, unë po i drejtohem ministres...

Milva Ekonomi – Ju lutem, nuk të lejoj...

Albana Vokshi – Po, të lutem, Milva, se nuk ka nevojë! Zonja Ministre...

Milva Ekonomi – Të lutem, se nuk mund të tejkalohet kjo sjellje!

Albana Vokshi – Nuk fyeri ju? Ne po i drejtojmë pyetje, merret me telefonin!.. Ju lutem, nuk ka asgjë më të rëndësishme se kjo dëgjese...

Milva Ekonomi – Ajo nuk merret me telefonin, sepse po mban shënime dhe po rri e po dëgjon të gjitha gjërat që po diskutojmë ne jashtë rendit të ditës.

Albana Vokshi – Të lutem, dëgjo edhe ti, Milva!

Kam një mesazh, një kërkesë nga asambleja e pedagogëve. Ju kanë dërguar një ultimatum, një deklaratë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, me telefon më erdhi. Juve ju vjen me telefon? Përfaqësues të asamblesë të pedagogëve më kërkojnë qëndrimin apo vullnetin e qeverisë në lidhje me deklaratën e tyre. Është një ultimatum që përfundon të premten, të cilët kërkojnë....

Milva Ekonomi – S'mund t'i kërkojnë përgjigje me ultimatum ministres për një gjë që ka afatin e vet.

Albana Vokshi – Të lutem, Milva, më lër...

Milva Ekonomi – Të lutem, lërë të përgjigjet për pyetjet që i kemi bërë. Mos i jep gjëra të tjera që nuk kanë lidhje fare me rendin e ditës...

Albana Vokshi – Si nuk ka lidhje?! Ashtu ju duket. Kam një kërkesë, ku kërkojnë nëse ju, si ministre e arsimit, keni vullnetin t'u përgjigjeni katër pikave. Është ultimatum që mbaron të premten. Ata kërkojnë shfuqizimin e ligjit të arsimit të lartë dhe hapjen e një procedure konsultimi për një ligj të ri. E kam kërkesë nga ata. Jua kanë bërë edhe publikisht. Sot kërkohet edhe prononcimi juaj.

Musa Ulqini – Faleminderit, Albana, drejtuese e kësaj mbledhjeje!

Zonja Ministre, unë respektin për ju e kam shprehur me votë ditën kur ju jeni votëbesuar, por kam shumë dëshirë që shumë shkurt dhe qartë të shpreh opinionin tim për ato që ju thatë këtu.

Dua t'ju falënderoj shumë fare, që në paraqitjen tuaj të parë bëtë një gjë që nuk është e lehtë të bëhet, kur ftohen përfaqësuesit e qeverisë në mbledhje të tilla, sepse respektuat në germë dhe në frymë këtë libër, që është Rregullorja e Kuvendit. Çdo njeri që vjen këtu, i ftuar nga ne, respektin për deputetët, për përfaqësuesit e popullit e shpreh kur respekton këtë Rregullore. Në respekt të kësaj Rregulloreje, ju erdhët dhe dhatë argumentet tuaja, duke respektuar 100% shkresën që ju dhe ne kemi përpara, e cila mban firmën e kryetares, zonjës Albana Vokshi. E them këtë, sepse edhe ju paraqitët argumentet tuaja dhe ishin argumente, të cilat janë shteruese. Kaq është kjo mbledhje. Kaq duhet të flisni ju këtu. Unë kam shumë vjet në këtë komision dhe dua të them se nuk është e lehtë të respektoni procedurën, pra të na respektoni ne, sepse vini këtu e dëgjoni deputetë, të cilët për shkak të protagonizmit të tyre, të dijeve dhe të mosdijeve që kanë, për shkak të interesave që përfaqësojnë, e kam fjalën për grupe të ndryshme të interesit, për shkak të axhendave politike që kanë, për shkak të mungesës së etikës që kanë, krijojnë situata, të cilat shumë herë ata që ftohen këtu, nuk kanë mundësi t'i respektojnë...

Albana Vokshi – Musa, ke ndonjë gjë për ligjin? Lëri lavdet për ministren, të lutem! Pyetjet për ligjin, se jemi në procedurë, ju lutem!

Musa Ulqini – Si hera e parë që jeni këtu, zonja Ministre, ju falënderoj në emër të përvojës sime të gjatë parlamentare! Bravo ju qoftë që në këtë takim dhatë shembullin se si respektohen procedurat, duke dëshmuar një respekt shumë të madh për parlamentin, për deputetët, për përfaqësuesit...

Albana Vokshi – Bravo ju qoftë që nuk i përgjigjeni asnjë kërkesë të studentëve!

Musa Ulqini – Gjithçka tjetër është ajo që thashë pak më sipër.

Faleminderit shumë!

Albana Vokshi – Të lumtë, Musa, edhe Enveri do ta kishte zili!

Luçiano Boçi – Për procedurë, Musa, më vjen keq për ty, se je deputet shumë i vjetër i Kuvendit. Në fakt, fjalën tënde e dëgjoj me vëmendje.

(Reagim pa mikrofon.)

Profesor, pardon, por kjo mënyra se si na u drejtua Musai... Musa, e nise që jemi në seancë dëgjimore me ministren, por na u drejtove neve. Mos e ngatërro drejtimin e fjalës! Se çfarë bëjmë ne për protagonizëm, për njohje, për mosnjohje, nuk e kam për veten time, se nuk kam asnjë lloj kompleksi ndaj fjalës sate, por e kisha fjalën për atë etikën tënde të famshme dhe njohjen e famshme të Rregullores... Në qoftë se pretendon se i ke të dyja tiparet, nuk duhej të flisje kundër kolegëve të tu me një gjuhë... Fyerjen e dini vetëm me epitete ju, sepse ju e performoni, e elaboroni dhe e trajtoni shumë bukur. I drejtoheshe ministres dhe kaq. Ky është rast i përsëritur. Më vjen keq që vazhdoni sërish në këtë formë në komision.

Albana Vokshi – Po, Vali.

Valentina Duka – Fillimisht, dua të përgëzoj dy koleget e mia të LSI-së, të cilat na sollën disa amendime këtu për ligjin e arsimit të lartë. I përgëzoj, sepse mendoj se kjo është rruga ligjore për të adresuar si duhet kërkesat e studentëve.

Por, duke qenë se jam deputete e PD-së, unë mbështes partinë time, ne nuk jemi për arnime të këtij ligji, por jemi totalisht për abrogimin e ligjit të arsimit të lartë.

Nuk i takoj atij soji politikanësh që mendon se sa herë ka rotacion politik në Shqipëri, duhet të ndryshojnë të gjitha ligjet, sepse veprime të këtilla prekin themelet e shtetformimit në Shqipëri. Por, duke qenë se ky ligj është një ligj klientelist, ka dëmtuar jashtë mase familjet shqiptare dhe të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik, ne mendojmë se në pjesën më të madhe të dispozitave të këtij ligji dëmtohet totalisht funksionimi si duhet i institucioneve të arsimit të lartë.

Ju kemi dëgjuar shpesh që thoni se studentët nuk ju adresuan ligjit të arsimit të lartë dhe ndryshimeve të tij në të gjitha kërkesat që paraqitën ndaj jush. E keni shumë gabim. Fakti që studentët mbushën sheshet e Tiranës, erdhën para jush dhe ju adresuan shumë kërkesa, tregon se ato kërkesa nuk mund të realizohen pa u ndryshuar dhe pa u abroguar ky ligj.

Zonja Ministre, universitetet nuk mund të funksionojnë sot pa rritur tarifat e universiteteve ose numrin e studentëve në universitetet publike. Është e vetmja mënyrë që universitetet të sigurojnë të ardhura për të funksionuar. Tani kanë dalë përfaqësues të ministrisë

ose njerëz që kanë bërë atë ligj, duke thënë se universitetet kanë hapësira të tjera për të siguruar fonde. Sigurisht kanë hapësira. I kemi thënë atëherë grupit të punës se ato hapësira që ligji u jep universiteteve në Shqipëri nuk mund të funksionojnë. Universiteti shqiptar nuk është universiteti i Harvardit, ku të gjithë CO-të e firmave më të mëdha amerikane japin donacione. Nuk është as universiteti i Haifës në Izrael, që fiton shumë para me shitjet e patentave. UT-ja dhe universitetet shqiptare janë universitete të reja, që prodhojnë modestisht aktivitet akademik, të cilat nuk mund të shiten as në tregun shqiptar dhe as në tregun global për të fituar para, por e vetmja mundësi, sipas ligjit tuaj, janë ose rritja e tarifave studentore, ose rritja e numrit të studentëve, çka ka sjellë uljen e cilësisë në mësimdhënien e universiteteve publike.

Revolta studentore tronditi qeverinë tuaj, tronditi opozitën, por sigurisht ka tronditur edhe universitetet shqiptare, prandaj është ngritur në këmbë senati i UT-së. Duhet të ngrihen më shumë senatet e universiteteve të tjera publike dhe janë ngritur në këmbë asamblatë e universiteteve.

Zonja Ministre,

Pakti juaj për universitetin, më vjen turp që po përdor këtë fjalë, është për t'u hedhur në kosh. Pavarësisht se është i bukur nga pikëpamja grafike, 95% të VKM-vë që keni hartuar dhe 100% të urdhrave shkelin hapur nenin 118 të Kushtetues që detyron qeverinë, ju detyron ju, që aktet nënligjore dhe urdhrat që nxirrni t'i mbështesni në ligj. A mund të na thoni se në cilin ligj jeni mbështetur për hartimin e këtyre VKM-ve?

Prandaj thashë që rruga ligjore është rruga që propozuan deputetët e LSI-së, kurse rruga juaj me VKM është rruga më e shtrembër. Në qoftë se në Shqipëri do të ishte Arsim Bajrami, ish-kolegu juaj i Kosovës, do t'ia hidhte në kosh të plehrave këtë ligj Ashim Thaçit.

Ju lutem, veproni kështu për të mësuar Kryeministrin shqiptar që në Shqipëri duhet të punohet dhe të ndërtohet me ligje, përndryshe shqiptarët do të nënshkruajnë një kontratë të re politike.

Faleminderit!

Albana Vokshi - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Rrokaj!

Shezai Rrokaj – Unë mendoj se ka ardhur çasti që partitë politike të heqin dorë nga kapitalizimi i revoltës dhe ta shohin revoltën si një shenjë të emancipimit shoqëror dhe si një preokupim të të gjithë aktorëve, përfshirë studentët, universitarët, profesorët, partitë politike si një e mirë kombëtare.

Zonja Ministre,

Ka dy probleme themelore: njëri që ka të bëjë me mënyrën se si qeverisjet e kanë parë shkollën dhe universitetin gjatë gjithë këtyre viteve të tranzicionit dhe një pjesë e problematikave që ngrenë studentët i takojnë gjithë tranzicionit; ka një problem tjetër që ka të bëjë me ligjin e arsimit të lartë, që detyrimisht për të mban përgjegjësi maxhoranca.

Unë mendoj se do të ishte në nderin tuaj dhe në përgjegjësinë tuaj që të hapeni ndaj shkollës në tërësi, por sidomos ndaj universitetit.

Po të isha në vendin tuaj, gjënë e parë që do të shikoja janë vërejtjet që kanë bërë universitarët për këtë ligj, që na ka rezultuar kështu dhe nëse vërejtjet që kanë bërë universitarët janë të drejta.

Unë kam qenë dekan në atë kohë dhe kam qenë kundër forcës sime politike për votimin në parlament, prandaj i kam shkruar gjërat dhe i kam të dokumentuara, kështu që mund të flas shumë lirisht.

Pra, gjënë e parë që duhet të bëni është të ngrini një grup pune, që të shikojë vërejtjet që janë bërë dhe problematikat që kanë ngritur studentët sot, nëse ka përkim midis tyre, sepse po ju them që ka ndryshuar komplet sistemi. Nga viti 2005 deri në vitin 2010-2011 funksionoi një sistem shkollimi i mbështetur mbi Kartën e Bolonjës dhe ne jemi nënshkrues të saj, unë kam qenë rektor në atë kohë dhe i di shumë mirë këto problematika, dhe pastaj në vitin 2015 tentoi PD-ja, por nuk e realizoi, iu futën një sistemi anglo-sakson, i cili, siç i bëjmë punët ne shqiptarët, pati shumë presione nga lobingje dhe pësoi ndryshime.

Për këtë kolegja ka të drejtë. Janë hequr ciklet e shkollimit. Ky ligj ka dy cikle shkollimi, s'ka tre, nuk e përfshin doktoraturën si cikël shkollimi, sepse doktoratura sipas konceptit të Bolonjës përfshin edhe një sistem formimi, që do të thotë sistem provimesh.

Së pari, është përdoruar koncepti “master ekzekutiv”, i cili s'ka lidhje fare.

Së dyti, ju e konsideroni masterin jo si detyrim shtetëror. Nuk e di nga e gjeni këtë të drejtë. Keni përmendur se asnjë vend nuk e ka, por unë do t'ju këshilloja, si edhe për tarifave të tjera, duke u nisur edhe nga vëllezërit tanë në Kosovë, që këto gjëra i kanë rregulluar më mirë se ne, ata janë treguar më dashamirës se ne ndaj arsimit për sa i takon tarifave të arsimit, kështu edhe në Maqedoni, të hiqni dorë nga koncepti që ata që marrin masterin, nuk janë studentë, kurse vetëm ata të *bachelor*-it janë studentë.

Ky është një sistem unik, i plotë, sipas Bolonjës dhe po ta shikosh, te ne, pothuajse të gjithë ata që mbarojnë *bachelor*-in shkojnë në master dhe qeveria ka detyrim t'u përgjigjet studentëve, edhe atyre të masterit, me përgjysmimin e tarifave, gjë që nuk shprehet në vullnetin tuaj, siç nuk shprehet edhe për studentët nga 5-6, për të cilët qeveria, nga viti që vjen, nuk merr përsipër uljen e tarifave.

A e kuptoni ju, zonja Ministre, që problemi i tarifave të ne nuk ka të bëjë aq me meritokracinë, siç po priret ta trajtojë qeveria? Me të drejtë, është shumë mirë që edhe studentët ekselentë t'i trajtojnë edhe universitetet, jam plotësisht dakord, por të ne çështja e tarifave ka të bëjë me gjendjen ekonomike, me varfërinë e familjeve shqiptare.

Ose vendosni rrogën, siç e keni vendosur, për trajtimin e një kategorie të caktuar të familjeve me ndihmë ekonomike, tetraplegjikët, paraplegjikët e kategori të tjera.

Deri më sot, që ta dini zonja Ministre, qeveria nuk i dëmshpërblente universitetet, por e paguanin këta studentë nga tarifat e tyre, që do të thotë se studentët me ndihmë ekonomike, këtë masë sociale, qeveria nuk e kthente në kompensim financiar ndaj universiteteve dhe unë jam ai që e konfirmoj këtë fakt.

Në qoftë se unë do t'ju bëja një pyetje, se edhe evolucioni në shkollë dhe në universitet ecën mbi bazën e asaj që quhet "acquis" dhe ju e dini mirë termin, ka "acquis communautaire", por ka edhe "acquis universitaire".

Në qoftë se ne kishim 20% në ligjin e parë, a kemi bërë hap prapa, duke e bërë 10% në ligjin aktual? Unë mendoj se kemi bërë hap prapa. Po nëse ata kërkojnë 50% dhe ne e dimë se sa i kanë vendet rrotull nesh, që vërtiten nga 10-25% (edhe mua nuk më del nga goja të them 50%, se kam drejtuar dhe e di), por do të thosha që ju mund të konsideroni që t'i ndani detyrimin që kanë studentët ndaj autoriteteve, pra mund të kishte një përqindje për zgjedhjen e autoriteteve dhe një përqindje tjetër për pjesëmarrjen e tyre në organet kolegjiale, ku studentët nuk janë thjesht pjesëmarrës, por janë vendimmarrës me ligj. Për këtë mund të hapej një diskutim me grupet e interesit.

Ky ligj shënoi një hap shumë prapa, sepse futi fjalë të bukura, siç janë donacionet, kreditë, projektet etj.. Të gjitha këto janë të mira, por nuk i arrijmë dot sot për sot. Nuk do ta bëjmë politikën për sot, po për 50 vjetët që do të vijnë. Ju nuk e rritët fondin e arsimit fare, por e mbajtët si qeverisjet e tjera, me plus-minus. Atëherë, nëse do të bësh një ligj siç duhet, duhet të merrje edhe kostot. Unë e di se ministrja do të dëshironte më shumë përqindje të GDP-së për arsimin. Ai 5%-shi nuk është kot, por është një detyrim europian, që tregon se çfarë vlerësimi i jep shoqëria arsimit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Faleminderit!

Kam edhe unë dy pyetje. Më vjen keq që ju kanë këshilluar gabim, që të vini këtu dhe të mos flisni. Ju duhet të vini këtu dhe të flisni në mbështetje të studentëve, se do të ishte në nderin tuaj, por këshilla që ju kanë dhënë që të vini dhe të mos flisni, se kështu shpëtoni, është kot, se dini që nuk do të shpëtoni.

Edhe nëse nuk u jepni sot përgjigje pyetjeve tona, do të vini nesër, do të vini pasnesër. Ne nuk do të heqim dorë nga kërkesat e studentëve, se ata janë të parët për ne, ndaj mua më vjen çudi se si kolegët e maxhorancës qeshin, kur Vali thotë që situata në universitete është shumë e rëndë. Si mund të qeshësh kur qindra mijëra studentë janë në rrugë duke protestuar!? Mijëra studentë janë të ngujuar, qindra pedagogë mbledhen ndër asamble dhe ju çojnë ultimatume...

(Diskutime pa mikrofon.)

Pyetje janë këto, pse si ju duken ju!? Mbani shënim, zonja Ministre!

Unë nuk di se si ju nuk i shikoni këto. E para.

E dyta, a po e nisni ju detyrën duke shkelur ligjin për arsimin parauniversitar?

Meqenëse keni qenë ish-zëvendësministre për arsimin parauniversitar, duke zhvendosur mësimin nga Juridiku te “Petro Nini”, a jeni ju në shkelje të nenit 32 të ligjit “Për arsimin parauniversitar”?

A jeni ju dakord që vajza të vogla 14-15 vjeçe, ky është shqetësimi i prindërve, të jenë në të njëjtin ambient me studentë?

Si mundet të nisni ju një detyrë si ministre, duke shkelur ligjet?

Ky është një shqetësim shumë i madh. Më kanë ardhur qysh dje pasdite mesazhe të tilla, ku shprehet shqetësimi i prindërve. Pyeteni ministren nëse ka marrëveshje për këtë lëvizje, sepse ju nuk e keni tagrin të bëni zhvendosje, por duhet një marrëveshje, ashtu siç bëhet marrëveshja kur bëhen zgjedhje. Vetëm në raste zgjedhjesh, mundet të përdoren ambientet e shkollave dhe kjo me një marrëveshje që bëhet midis institucioneve. Është një shqetësim shumë i madh. Shiheni me kujdes, zonja Ministre! Mos e nisni me shkelje ligji! Është antiligjore ajo çka doni të bëni.

Pasi i shantazhuat, pasi i kërcënuat, siç thanë edhe kolegët e mi, tani po shkelni ligjin, se në bazë të nenit 32, i takon vetë shkollës ta administrojë.

Besa Shahini – Ju lutem, zonja Vokshi, m’i nisni me një shkresë dhe do t’ju kthej përgjigje me shumë dëshirë. Mund të vij edhe në një moment tjetër. Më duhet të largohem. Faleminderit shumë për mirëkuptimin!

(Ministrja largohet.)

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Kjo është e turpshme! Bravo ju qoftë! Skenari juaj funksionoi. Është e turpshme të lihet komisioni, të braktiset mbledhja. E bëtë dje këtë gjë, braktisët mbledhjen, dëgjuesën me ministrin, sot prapë e këshilluat ministren që të braktisi mbledhjen e komisionit. Është e turpshme dhe sa mirë që të gjithë qytetarët po e shohin se kë ka vënë ministre Edi

Rama, se cilët ka deputetë Edi Rama, që nuk u intereson absolutisht asgjë nga problematikat e studentëve apo familjeve të tyre, por i intereson vetëm interesi i pushtetit të tij.

Turp për ju, kolegë të maxhorancës, që nuk reagoni ndaj braktisjes së komisionit! Kjo është antikushtetuese, është antiligjore, është antijetike dhe është fyerje e madhe për të gjithë ne deputetët. Nuk jemi vetëm të PD-së, nuk jemi vetëm të LSI-së, jeni edhe ju të PS-së. Ka me qindra mijëra familje që janë para televizorit, duke pritur përgjigjet e ministres. Reagoni! Bëhuni palë me të drejtën! Reagoni! Mos heshtni, sepse një karrige nuk është e gjithë jeta! Është turp që ju i lini studentët të ngujuar, duke pritur të marrin përgjigje nga ministrja. Unë nuk di çfarë ka më përtej kësaj.

Do t'i kërkoj Edi Ramës që të mos provokojë më në mënyrë të tillë, të mos u kërkojë ministrave të braktisin komisionet. Unë do të informoj edhe delegacionin e BE-së, edhe ambasadat, edhe Brukselin, sepse në mbledhjen e fundit të Komitetit të Stabilizim- Asocimit, njëri prej kushteve të rezolutës është bashkëpunimi pozitiv-opozitiv, është respektimi i mbikëqyrjes parlamentare. Ju nuk po na e mundësoni mbikëqyrjen parlamentare.

Kejdi Mehmetaj – Për procedurë. Unë nuk kam parë e dëgjuar ndonjëherë që një prej të ftuarve të largohet pa na dhënë asnjë përgjigje. Ne e mirëkuptuam punën e zonjës ministre, edhe pse Kryeministri 80% të kohës mbledhjen e qeverisë e ka drejtuar me zëvendëskryeministër. Atje mund të shkojnë zëvendësministrat, sepse ai ka bërë zëvendësministrin e Jashtëm, ministër. Tani, kaq e domosdoshme është prezenca e ministres në një mbledhje rutinë, krahasuar me këtë situatë?! Gjithsesi, ne e mirëkuptuam, por minimumi që mund të bënte ministrja ishte të kërkonte kohën për të shkuar në mbledhje dhe të vinte sërish për të vazhduar seancën, ose të linim një orar të dytë. Ne këtu jemi seriozë, megjithatë ju them sinjorisht se mendoj se ministrja sot u ka bërë një nder shumë të madh qytetarëve për të kuptuar se ku po e çon Kryeministri Shqipërinë, nga shiu në breshër. Qenkemi ankuar nga ca ministra, por gjej rastin t'i vlerësoj, se të paktën kanë ndenjur me dinjitet në këtë komision dhe kanë përballuar debatin me të mirat dhe me të këqijat e tij. Por kjo sot, që të mos kthesh përgjigje, të ikësh pa marrë leje, është alarmante!

Albana Vokshi – Është skenar i urdhëruar nga Kryeministri.

Kejdi Mehmetaj – Nuk e di, zonja kryetare, se çfarë masash duhet të marrim ne për këtë gjë, por unë them që jo thjesht në Rregullore, se për mua rregullorja është pak, kjo që ka ndodhur sot është alarmante. Shqiptarët ta shikojnë mirë se ku kemi kaluar, se, të paktën, ata ministra që ishin, kishin dinjitet dhe integritet, rrinin këtu dhe mbronin argumentet e tyre, dhe unë i vlerësoj për këtë.

Milva Ekonomi – Po e marr fjalën për procedurë. Në fakt, ne duhet të kemi parasysh një gjë. Ne, si komision, e kemi treguar me kohë që jemi një komision që nuk dimë të administrojmë kohën dhe kjo që na ndodhi sot është pikërisht një nga këto skena, ku ne jemi administrues jo të mirë të kohës. Komisioni i Edukimit dhe Medies nuk e administron kohën që ka në dispozicion. Në një shkresë të protokolluar qysh dje, ministrja na vuri në dijeni të gjithëve, që në orën 11:00 ka mbledhje qeverie. Pranuar edhe sot që në orën 11:00 kishte mbledhje qeverie. Në fakt, gjëja që ndodhi ishte se ne dolëm jashtë rendit të ditës. Kishim një rend dite për propozimin që keni bërë ju, për rritjen e përfaqësimit të studentëve në nivelet e marrjes së vendimit. Përgjigjen për atë propozim që kishin bërë dy përfaqësuesit e LSI-së ne e morëm. Ndërkohë që asnjëri nga ne nuk kishte bërë një kërkesë për dëgjues për ato gjëra që kanë të bëjnë me arsimin e lartë. Përveç kësaj, kemi edhe një të drejtë tjetër, ne mund të bëjmë edhe një kërkesë që ministrja të vijë dhe t'u përgjigjet të gjitha pyetjeve që ka marrë zonja Albana edhe në telefon, edhe nga portalet, edhe me shkrim. Por kjo e sotmja ishte shembull i pamundësisë që kemi ne për të menaxhuar kohën e punës në komision.

Albana Vokshi - Milva, distancohu!

(Diskutime në sallë.)

Të paktën për studentët duhet të kishit reaguar ndryshe.

Milva Ekonomi - Duhet të vazhdojmë me rendin e ditës.

Albana Vokshi - Është brenda rendit të ditës. Çdo pyetje që kanë bërë deputetët...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Iku ministrja. Kemi kohë të gjithë, do të flasim.

Pyetjet që bënë Luçiano, Luani dhe me radhë të gjithë deputetët, kishin lidhje me amendimet. Çdo gjë lidhet me amendimet dhe me ligjin “Për arsimin e lartë”.

Distancohuni sa jeni në kohë! Keni studentët atje! Bëjeni për fëmijët tuaj, mos e bëni për ne!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të vijë radha.

Jo, nuk e ke radhën ti. E ka zonja Malaj.

Nuk ka axhendë qeverie më të rëndësishëm sesa studentët.

Nora Malaj – Në respektin tuaj, por edhe të institucionit, unë këtë fjalë do ta mbaj në këmbë. E di që Shqipëria është republikë parlamentare dhe e di që parlamenti prevalon mbi çdo gjë tjetër. E di që institucioni i Kryeministrit, Kryeministri dhe e gjithë qeveria duhet të raportojnë për zbatimin e ligjit. E di që jemi në një situatë të jashtëzakonshme dhe jo në situatë të zakonshme. E di që njerëzit jo vetëm po na ndjekin sot, por përtej politikave dhe bindjeve

politike është e drejtë kombëtare për t'u informuar. Ministrja e re në detyrë, minimalisht duhet të linte një përfaqësues, nëse ajo me të vërtetë e kishte të domosdoshme të shkonte në mbledhjen qeveritare, për t'i kthyer përgjigje senatit që po pret deri ditën e premte dhe të merrte të gjitha pyetjet shteruese për nevojat që ne kishim për zgjidhje. E gjithë farsa e ndërtuar mbi pseudovendimet e VKM-ve, është e pabazuar, në shkelje të ligjit dhe të gjitha aktet tona nënligjore, si në rastin e parë për rritjen e buxhetit, si në rastin e dytë për ndryshimin e ligjit, do ta ndihmonin në zgjidhjen e problemeve. Përtej këtyre fakteve, ajo që unë ndjeva dhe kam revoltë është se asnjë nga koleget tona ish-ministre, në respekt të tyre, në mirëseardhjen e tyre në këtë komision, kur kemi kaluar situata shumë të vështira, jo vetëm që janë përgjigjur, por kanë mbajtur ndoshta dhe përgjegjësi, dhe janë ndierë ndonjëherë të frustruara nga debati që kemi bërë. Është e pafalshme që ministrja e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk merr përgjegjshmërinë maksimale, por fyen etikën qytetare të bazës së komunikimit, që lidhet me informacionin e dedikuar, me nevojën që kanë qytetarët për të marrë informacion, lidhet me zgjidhjet e problemeve dhe me çdo gjë tjetër që është pjesë e zgjidhjes së problemit.

Prandaj, mendoj se sot jo vetëm që nuk na tha asgjë, jo vetëm u mundua t'i ikte problemit, por mendoj se me të gjitha vendimmarrjet që ka bërë deri tani, është në një situatë jashtëzakonisht shumë të rrezikshme për gjendjen dhe për zgjidhjen e problemeve.

Të nderuar kolegë, ju ftoj që t'i bëjmë thirrje të kuptojë se ardhja këtu në komision nuk është dëshirë, por detyrë, detyrë kushtetuese, aq më tepër në këtë situatë.

Faleminderit!

Luçiano Boçi - E kam për procedurë.

Bujar, meqenëse je në "opozitë", po të respektoj.

Bujar Çela – Është nder i madh që ma jep fjalën një anëtar i opozitës. Unë gjithmonë e kam respektuar opozitën, se edhe vetë nga shpirti jam opozitar. Kam tentuar disa herë të dal, të rreshtohem nga ajo anë, por ju nuk keni pranuar.

Albana Vokshi - Ju lutem, për procedurë!

Bujar Çela – Procedura ime është fare e thjeshtë. Falënderoj dy studentet për amendamentet që i sollën në emër të kolegëve të tyre! Falënderoj ministren për ato çfarë shpjegoi...

Albana Vokshi – Për çfarë e falënderon ministren? Ku e ke ministren?

Bujar Çela – Të lutem!

Albana Vokshi - Po falënderon karrigen, se nuk është ministrja! E urdhëroi Rama dhe iku!

Bujar Çela – Albana, unë kam dalë hapur në mbrojtje të kryetares së Komisionit edhe atëherë kur PD-ja nuk ju ka dhënë votën për kryetare, sepse kam bindjen që ju detyrën opozitare e bëni më mirë se kushdo, por vetëm hallin e studentëve dhe të pedagogëve ju nuk i keni qarë asnjëherë, sepse ju dini të prodhoni vetëm kioska, jo akademi...

Albana Vokshi – Ja, diplomën nga kioska e ka marrë!

Pyete pak ish-ministren, se ku e ka marrë diplomën. Mos u fut këtu, se fyen ministren, se e ke kolege tani!

Bujar Çela - Për procedurë, jam në vijim të bisedës për të thënë se ministrja dhe qeveria sot janë duke diskutuar për studentët dhe pedagogët. Nuk janë duke diskutuar jashtë këtij rendi që po diskutojmë. Unë mendoj, ky është propozimi, se në bazë të pyetjeve që bëtë për amendamentet e dy kolegeve dhe të situatës ku ndodhemi, të diskutojmë si komision dhe të dalim me një konkluzion: a duhet të përcillen këto në seancë plenare, a duhet të bëjmë rregullime, ndryshime, sepse tjetër gjë thuhet jashtë nga këto brenda? Nuk janë 140 mijë studentë, ndoshta janë edhe 140 prindër, ndoshta janë 14 mijë, ndoshta janë 1,4. Ku e dimë sesa mund të jenë? Të diskutojmë për pyetjet dhe shqetësimin, dhe të marrim një vendim kolegjal si komision, në mënyrë që zëri ynë të jetë i dëgjueshëm.

Albana Vokshi - Kush do të japë përgjigje?

Bujar Çela – Nëse do t'i bjerrë njëri gozhdës, tjetri patkoit, ne do të bëjmë siç kemi bërë.

Albana Vokshi - Do të japësh ti përgjigje për pyetjet apo ish-ministrja?

Bujar Çela - Ne të dalim me një vendim si komision.

Albana Vokshi - Dilet me një vendim, nëse ti merr informacionin e duhur për të gjitha problematikat që ngritën kolegët. Pasi merret informacioni i duhur, bëhet diskutimi. Më fal që duhet t'ju shpjegoj edhe procedurën!

Bujar Çela – Pyetjet që bënë kolegët, t'i marrim të gjitha bashkë dhe të dalim në një mendim, të shikojmë se çfarë mund të bëjmë, sepse ka edhe përgjegjësi të tjera, jo vetëm kjo që është sot ministre.

Luçiano Boçi - Ne mund të themi të gjitha fjalët e revoltës, pasi skena foli më shumë sesa fjalët tona dhe është e tepërt që të shtonim edhe emfazën tonë politike.

Unë mendoj të kërkojmë me urgjencë thirrjen e ministres së Arsimit në dëgjuesë me një të tretën e firmave. Mund ta hidhni si propozim, nëse kolegët e maxhorancës janë dakord, po për ditën e sotme, sepse duke iu referuar Norës, seanca dëgjimore nuk mund të ndërpritet, aq më tepër që ishin edhe përfaqësuesit e ministrisë. Nuk e di, por dikush prej tyre është zëvendësministër apo këshilltar ligjor, shef i kabinetit, sekretari i Përgjithshëm, mund të

vazhdonin. Në raste të tjera, ju na keni dërguar edhe sekretarin e Përgjithshëm në komision. Nuk është çudi për ju, është çudi për komisionin, por seanca dëgjimore duhej të vazhdonte, aq më tepër, Milva, që si orar ne kishim përcaktuar orën 11:00. Ora 11:00 është tani. Kohë më parë ministrja u largua në mënyrë demonstrative, pa dhënë asnjë përgjigje të çështjeve dhe pyetjeve që ngritëm ne. Minimalisht duhet të kishte dhënë përgjigje për dy çështje themelore: çështjen e ndërhyrjes së forcave policore në ambientet universitare dhe çështjen e asamblesë së pedagogëve që kërkojnë abrogimin e ligjit “Për arsimin e lartë”, heqjen e VKM-ve që penalizojnë sot pedagogët. Përgjigjet që janë parashtruar këtu, nuk janë përgjigje. Unë nuk kam përgjigje nga parashtrimi që bëri ministrja, sikurse edhe propozueset nuk kanë përgjigje. A i keni lexuar përgjigjet? Nuk janë përgjigje, nuk ka përgjigje, sepse për një nga kërkesat për bordin e administrimit, nuk ka as pohim, as mohim, vetëm parashtrohet një argument, ku thuhet se po veprohet në këtë lloj forme. Përfaqësuesi i ministrisë dhe vetë ministrja mohoi të ketë një përgjigje pozitive, ndërkohë që në shkresë ka përgjigje pozitive. Unë këtë nuk e kuptoj. Ka moskoherencë totale, nuk ka lexuar as raportin.

Prandaj, ju lutem shumë, me dakordësinë tuaj ne të vazhdojmë seancën dëgjimore, qoftë për propozimet e sjella, qoftë për problemet e tjera. Pra, propozimi im është shumë i thjeshtë: në orën 15:00 në mënyrë urgjente të vazhdojmë seancën dëgjimore. Nëse nuk quhet vazhdim, atëherë rithirrje të ministres së Arsimit për një seancë tjetër dëgjimore brenda ditës së sotme. Kjo është kërkesa jonë dhe e vendosim.

Albana Vokshi - Ne si opozitë kërkojmë që ministrja të vijë në orën 15:00, për t’iu përgjigjur pyetjeve që u parashtruan për të vazhduar dëgjesën ose një dëgjesë të re. Ne do t’i mbledhim tani firmat për t’ia dërguar, është urgjente që ministrja të paraqitet sot. Kemi studentë të ngujuar, të cilët presin përgjigje; kemi qindra pedagogë, të cilët kanë bërë një ultimatum; ka mijëra familje shqiptare, të cilat presin përgjigje nga ministrja, nga ekzekutivi dhe nga parlamenti. Duke e konsideruar largimin e ministres një akt të turpshëm, të urdhëruar nga Edi Rama, një akt antikushtetues dhe antiligjor, i cili tregon fytyrën e vërtetë të kësaj qeverisjeje, që nuk i intereson aspak studenti apo mbarëvajtja e studimeve nëpër universitete, do të kërkoja që në orën 15:00 të thirret ministrja për të vazhduar këtë dëgjesë. Kush është dakord?

Kejdi Mehmetaj - Të lutem, ta theksojmë, që të mos kemi të njëjtën situatë, kur ministrja të thotë: “Më bëni një ftesë të re”, të jetë e pranishme ministrja për pyetjet lidhur me amendimet, që nuk mori mundimin, por edhe për pyetjet e tjera.

Albana Vokshi - Do të bëjmë një shkresë të re. Kush është dakord që në orën 15:00 të...

Milva Ekonomi - A mund të them diçka për procedurë?

Albana Vokshi – Mund të jeni dakord; nëse jo, ne mbledhim një të tretën e firmave. Ju e keni detyrim, por është edhe në nderin tuaj. Hajdeni ta bëjmë bashkë!

Milva Ekonomi - Nderin tonë na lë ta mbrojmë vetë.

Albana Vokshi – Milva, ke qenë vetë ministre. Duhet pak respekt për parlamentin. Nuk shkelet me të dyja këmbët Kushtetuta!

Milva Ekonomi – Unë kam shkuar nëpër komisione shumë shpesh. Problemi që kemi për ta thirrur ministren në dëgjese lidhet me dy momente të rëndësishme. E para, kërkon përgjigje për pyetjet që ishin jashtë amendimeve, depozitohet, bëhet gati dhe dërgohet!

E dyta, ju thoni se është moment i vështirë debatesh me pedagogët, me studentët, ndërkohë ministrja do të gjejë një rrugë komunikimi dhe nuk është vetëm ekrani i medieve që thërrasim ne, kur jemi në komision. Lëreni ministren të komunikojë deri të premten, kur është data e fundit e asamblesë dhe të mos kërkojmë një dëgjese që do të jetë po njëjloj. Ka një axhendë tjetër, nuk është axhenda e komisionit tonë axhenda e ministres. Unë mendoj se është në të mirën e komisionit...

Albana Vokshi – Po flasim për axhendën e komisionit. Nuk do të dish se çfarë planesh ka qeveria?

Milva Ekonomi - Qeveria po punon për planet. Jepini kohën sot për të punuar.

Albana Vokshi - Ju jeni të informuar, ndërsa ne jo.

E vazhdojmë me ministren, nëse nuk ju duket e arsyeshme që t'i kërkohej ministres për të trajtuar çdo problematikë, shqetësim në lidhje me ligjin “Për arsimin e lartë”.

E dyta, pakti për universitetin, çështja e zhvendosjes që është antiligjore, çështja e ultimatumit të asamblesë, a ju duken këto pyetje të mjaftueshme që ministrja të vijë dhe për çdo pyetje tjetër që futet në to? Sot pasdite në orën 15:00 do të thërrasim përsëri në një dëgjese urgjente ministren...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kërkuat fjalën? Po, më falni!

Fadil Nasufi - Me njëri-tjetrin si anëtarë të komisionit, besoj jemi të qartë. Për të qenë të qartë me publikun: rendi i ditës, e mërkurë 30 janar, ora 09:00, pika e parë, diskutimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nismë e deputetit. Jemi komisioni përgjegjës, do të diskutohet në seancë plenare në datën 31 janar. Prezantim nga Kejdi Mehmetaj...

Albana Vokshi - Zoti Nasufi, e dimë. Të lutem!

Fadil Nasufi - Po me këtë pikë është thirrur ministrja për ndryshimet e propozuara nga LSI-ja, e cila ka paraqitur 4 amendamente. Përgjigja e ministres ishte me shkrim, u dha edhe me dëgjese publike. Në rast se do të kërkojmë për të gjitha problematikat që fillojnë që nga Facebook-u dhe deri te problemet që ka parashtruar protesta, hartoni një për një kërkesën...

Albana Vokshi – Ne të parët kemi qytetarët. Nuk gjejmë zgjidhje te ju dhe vijnë te ne.

Fadil Nasufi - Mos më ndërhy! Hartoni kërkesën për ministren, si kryetare e Komisionit, me pika të veçanta për abrogim ligji, për dhunim...

Albana Vokshi – E dimë ne se si do ta bëjmë. Ministrja nuk iu përgjigj as atyre. Mua më vjen keq se si ju i ndani...

Fadil Nasufi – T’i dërgojmë kërkesën dhe të na japë shpjegime.

Albana Vokshi - Ministrja nuk dha asnjë përgjigje! Nëse ju i keni të qarta, ne nuk i kemi. Është kontradiktore dhe në shkresën që ka dërguar, me ato që tha se nuk ka dijeni të thella për ligjin “Për arsimin e lartë”. Për fat të keq, nuk e ka dhënë përgjigjen. Ti je i informuar, unë jo. Unë kam të drejtën që ministrja të qëndrojë këtu derisa unë të marr përgjigjen që dua. Çdo pyetje tjetër ka lidhje me ato 4 pika. Është detyrim kushtetues.

Ju ose hajdeni, ose jo. Ju e bojkotuat. Sot e bojkotoi ministrja.

Fadil Nasufi - Jam dakord t’i nënshtrohemi një debati, por me procedurë.

Albana Vokshi- Po, brenda procedurës.

Milva Ekonomi – Duhet t’ia bëjmë me dije, që të përgjigjet për pyetjet që nuk i ka dëgjuar.

Albana Vokshi – Ministrja duhet t’i dijë. Ti i di më mirë sesa ajo. Ja kemi ish-ministren këtu.

Të lutem! Kur bëre pyetje për arsimin e lartë, ish-ministrja mund të të jepte një përgjigje, apo jo? Ajo është ministre, duhet t’i dijë gjërat. Ka një staf.

Kejdi Mehmetaj - Më vjen keq që nuk jeni treguar të vëmendshëm dhe pse nuk është e thënë që ta dëgjojmë në maksimum njëri-tjetrin, por personalisht kam folur vetëm për amendimet, nuk kam dalë asnjë gram jashtë tyre. I mbaj mend, sepse i shënova pyetjet e mija, kam folur vetëm për amendimet që kemi propozuar, si edhe fjalët që tha ministrja. Është detyrim për të, kur vjen në komision, të më kthejë përgjigje, për atë që ju e cituat se e keni me merak të madh se mos ministrja thotë ndonjë gjë jo siç duhet. Fola vetëm për amendimet dhe ministrja nuk ka dhënë përgjigje. Ka detyrim që të më japë përgjigje.

Zonja nënkryetare ju e dini këtë gjë. Po supozojmë se ministrja nuk flet dot për asgjë tjetër, por për atë që ajo ka ardhur në komision duhet të japë shpjegime. Ministrja këtë

gjë nuk e bëri, iku në mënyrë shumë të pasjellshme. Duhet të vijë këtu dhe të japë shpjegime për fjalët e saj, në radhë të parë. Kjo është në mënyrë të padiskutuar, që seancën ta zhvillojmë patjetër sot dhe ajo përpara se të ikte të tregonte minimumin e etikës që të linte me ne një moment të dytë, sepse ne u treguam shumë mirëkuptues ndaj axhendës së saj, për të kthyer përgjigje.

Së dyti, këtë këtu që është pakt për universitetin e kemi mbi tavolinë. Dikush e solli këtë këtu tani.

Albana Vokshi - E solli në referencë me dëgjesën.

Kejdi Mehmetaj – Për sa kohë dikush e solli këtu te ne, nuk e kemi sjellë ne, nuk e keni sjellë as ju, se jeni deputete, e ka sjellë Ministria e Arsimit ose qeveria. Ata duhet të na përgjigjen ne për këtë dokument që na e kanë vënë mbi tavolinë dhe jo të vijnë këtu, të na thonë se nuk e dimë për çfarë po flasim. Ta dëgjojnë të gjithë. E kemi ne, nuk e prodhuam ne. Nuk e vumë ne, por na e sollën me *e-mail*, e kemi mbi tavolinë. Tani duhet të përgjigjen për këtë gjë që sollën.

Sot është dita e 57 e protestës, ministrja edhe nëse nuk ka qenë më parë minister, ka qenë zëvendësministre. Nëse në ditën e 57 të protestës nuk ka një përgjigje për atë që po ndodh apo qeveria nuk ka një përgjigje, nuk kanë për ta pasur kurrë. Le ta dinë këtë gjë qytetarët. Le ta kenë këtë gjë të qartë qytetarët.

Ne nuk mund të fshihemi as pas gishtit dhe as pas gjërave që nuk ekzistojnë.

Zonja kryetare, do të votoj për këtë gjë, që ministrja të vijë në orën 15:00 për të kthyer përgjigje për amendimet. Njëkohësisht bëjani të qartë ministres se do të kthejë përgjigje për të gjitha pyetjet dhe nuk ka nevojë për ditë shtesë, sepse ka pasur 57 ditë kohë në dispozicion, ka draftuar dokumente, prandaj të vijë të përgjigjet për këto gjëra.

Albana Vokshi - Jeni dakord të vijë ministrja në dëgjesë në orën 15:00 për të gjitha shqetësimet e ligjit “Për arsimin e lartë”?

Milva Ekonomi - Ministres i duhen dërguar pyetjet me shkrim.

Albana Vokshi – Nuk i di ministrja problemet?

Milva Ekonomi - Duhet të negociojmë momentin kur ajo do të paraqitet, sepse ju sot bëtë pyetje të reja. Problemi është se kjo situatë kërkon prioritet dhe prioriteti është sipas grupeve të interesit.

Albana Vokshi – Prioriteti është këtu, jemi republikë parlamentare.

Milva Ekonomi - Komisioni ynë është forumi ku mund të shprehet grupi i interesit.

Albana Vokshi – Kush është pro që ministrja të vijë sot në komision në orën 15:00? Ministrja duhet të vijë, sepse është detyrim kushtetues, por a jeni ju dakord apo jo? Ne do

të mbledhim firmat e një të tretës së anëtarëve, do të thërrasim ministren në orën 15:00, nuk vjen në orën 15:00, do ta lëmë në orën 16:00. Ju përgatituni dhe mos ikni nëpër rrethe, sepse e keni detyrim kushtetues.

Ju lutem, të mbledhim firmat dhe të dërgojmë shkresën në mënyrë urgjente!

Do të vazhdojmë me dëgjesat dhe pastaj do të rifillojmë me diskutimin.

Mbyllet pika e dytë e rendit të ditës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.01.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

3. Vendim i komisionit për shpalljen e 3 vendeve vakante për anëtarë të Këshillit Drejtues të RTSH.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj, Endri Hasa(zëvendësues) dhe Floida Kërpaçi(zëvendësues).

Mungojnë:

Romeo Gurakuqi.

Vijon pika e tretë e rendit të ditës

Milva Ekonomi - Në rendin e ditës kemi dy çështje.

Albana Vokshi – Po, për kandidaturat e reja për 3 vende të reja vakante në Këshillin Drejtues të RTSH.

Tre anëtarët e KDRTSH që ju ka mbaruar mandati më datë 4 dhjetor 2018 janë:

1.Xhemal Mato,

2.Valbona Sulçe,

3.Xhelil Aliu.

Jeni dakord me vendimin për shpalljen e dy vakancave të reja? Dakord. Kanë një muaj kohë.

Mbyllet mbledhja.

Rifillojmë në orën 15:00.

MBYLLET MBLEDHJA